RAPORTI PËRFUNDIMTAR
MBI
Auditimin Financiar

Tiranë, shtator 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	3-7
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	6-7
II.	**HYRJA**	7-12
1	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2	Identifikimi i çështjes	7-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5	Kriteret e vlerësimit	9-10
6	Standardet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	12-70
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-12
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	12-70
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	12-21
2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	21-26
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2025	26-47
2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2025	47-58
2.4	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna	58-71
2.5	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	71
IV.	**REKOMANDIME**	71-87

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Vau i Dejës është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe 5 njësi administrative si vijon: njësia administrative Vau i Dejës (qyteti), njësitë administrative Bushat, Hajmel, Vig - Mnelë, Shllak, Temal.

Sipas Censusit të vitit 2024 numëron një popullsi prej 19,261 banorësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 499.09 km^2. Bashkia e Vaut të Dejës zgjerohet me 5 komuna, të cilat merren kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit. Komuna e Bushatit, e cila i shtohet Bashkisë së re është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, Komunat Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës dhe pa lidhje historike me bashkinë e re. Këto dy komuna janë veçanërisht të varfra me tokë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmbytur nga liqeni i Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës. Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës.

Misioni i Bashkisë Vau i Dejës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetëqeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Vau i Dejës si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *"1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Vau i Dejës si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Vau i Dejës për periudhën e aktivitetit 2025 qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit
Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Vau i Dejës.
Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:
- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.*
- *mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në pasqyrat financiare.*
- *mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupet e mëparshme.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 19 gjetje dhe ka dhënë 19 rekomandime, nga ku masa organizative me 15 gjetje dhe 15 rekomandime, 4 gjetje dhe 4 rekomandime në vlerën 379,361 mijë lekë masa për eleminimin e efekteve negative në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me*:*

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të ardhurave***

1- Nga auditimi i llogarisë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Vau i Dejës për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 226,389,688 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën:
- prej 217,088,953 lekë për taksat dhe tarifat ndaj kategorisë familjar;
- prej 9,300,735 lekë detyrime të tjera.
Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë" (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.
2- Nga auditimi i llogarive nr. 210 "Toka, Troje, Terrene" nr. 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" të pasqyrave financiare, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:
-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;
-Vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës dhe ish Komunave, aktualisht Njësi Administrative.
3- Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2025, ka rezultuar se nuk është nxjerrë urdhri Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës për kryerjen e procesit e inventarizimit të aktiveve, si rrjedhojë llogarite analitikë janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 2, neni 4, pika 9; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5 pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.

4- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2025, rezulton se është realizuar në masën 53%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 2,156,854,033 lekë është realizuar vlera 1,135,388,670 lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një viti më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.
"Menaxhimi i Mbetjeve" është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 78,894,303 lekë është realizuar në masën 24,835,806 lekë ose 31%. Kjo tregon se planifikimi dhe ndjekja e zbatimit të programit nuk kanë siguruar një realizim në përputhje me objektivat e miratuara, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936/2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, për planifikim realist dhe përdorim efektiv të fondeve publike.
Detyrimet e prapambetura të raportuara në fund të vitit 2025, konstatohet se janë në vlerën 4,919,303 lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit prej 693,373,988 lekë, zë 0.71 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.
-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Vau i Dejës, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 29 raste për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 20,605,376 lekë.
5- Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 është në vlerën **254,991,805 lekë** lekë, nga të cilat vlera e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2025 është 43,130,498 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2025 janë në vlerën 74,522,151 lekë.
Sa më sipër, në krahasim me vitin 2024, vlera debitore është ulur me 31,391,653 lekë. Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Vau i Dejës në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta. Për debitorët e mësipërm nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Kontrollit dhe Borxhit Tatimor Bashkia Vau i Dejës, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, janë mjaftuar me masat shtrënguese si, dërgimin e njoftimit të detyrimeve si dhe urdhërat për bllokimin e llogarive bankare të nivelit të dytë për subjektet debitore, por nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:
1- Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë nr. 470 "Të ardhura për t'u marrë".
2- Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës, të marrë masat e nevojshme, për:
- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 "Toka, Troje, Terrene", nr.211 "Pyje, kullota, plantacione" dhe nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione".
- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
- Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të marrë masat e nevojshme për kryerjen e procesit të inventarizimit fizik të Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra Materiale.

- Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrin masa për përmirësimin e planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit, duke u bazuar në nevojat reale dhe në burimet e disponueshme të financimit, si dhe të hartojnë e zbatojnë grafikun për likuidimin në kohë të detyrimeve të prapambetura, duke analizuar periodikisht devijimet nga plani, me qëllim rritjen e realizimit të programit dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Kontrollit dhe Borxhit Tatimor në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **254,991,805 lekë**.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Vau i Dejës për periudhën ushtrimore 01.01.2025 – 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, Pasqyrat Financiare të vitit 2025, me përjashtim të rasteve të cilësuara në "Bazën për opinion e kualifikuar", paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit më 31 dhjetor 2025, referuar kuadrit rregullator të zbatuar nga njësia për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare".

***Baza për opinion të kualifikuar*[1]:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Vau i Dejës, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705).

Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 19,146 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Llogaritë e Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra Materiale, janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik;

-Llogaria nr.468 "Debitorë të ndryshëm", është pasqyruar më pak për vlerën 226,389,688 lekë;

-Llogaria nr.26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet", është pasqyruar më pak për vlerën 1,273,524,100 lekë;

-Llogaria nr.681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit" është pasqyruar më shumë për vlerën 293,249,565 lekë;

1 **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura**".

-Llogaria nr.467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 298,313 lekë;
-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 40,587,301 lekë;
-Llogaria nr.4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” është pasqyruar më pak për vlerën 35,265,763 lekë;
-Llogaria nr. 203 “Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme” është pasqyruar më pak për vlerën 2,109,847 lekë;
-Llogaritë nr. 42; 431, 435 dhe 436 janë pasqyruar më pak për vlerën 1,524,942 lekë;
-Llogaria nr. 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” është pasqyruar më pak për vlerën 1,451,880 lekë;

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr.734/1 prot., datë 01.07.2026, i miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01.07.2026 deri në datë 24.07.2026, në subjektin Bashkia Vau i Dejës për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1.A. G, përgjegjës grupi;
2.K. K, auditues;
3.K. P, auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objekti dhe qëllimi i auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Vau i Dejës.

Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vau i Dejës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Vau i Dejës.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.
Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës *(Administratori i Përgjithshëm)*, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Vau i Dejës, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.
NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.
Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[2]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e audituesve.
Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Vau i Dejës dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Vau i Dejës është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria

[2] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *"Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në Ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit:
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;
Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm publik*";
Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar;
Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*";
VKM nr.83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*";
Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar;
Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*";
Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "*Për miratimin e manualit të MFK*";
Urdhri i ministrit të Financave nr. 100, datë 16.10.2017 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*".
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:
Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*";
Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*" i ndryshuar;
VKM nr. 783 datë 22.11.2006 *"Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël"*;
Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"*;
UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* etj.;
Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, i ndryshuar;
Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar;
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar;
Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*";
Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 "*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021*", pikat 88-125;
Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 "*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023*", pikat 95-122;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*".

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*";

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*";

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar;

Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr.3237 datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*";

Udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 "*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*".

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në RSH"*, i ndryshuar;

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave lokale"*, i ndryshuar;

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar;

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*", me ndryshime;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*";

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*", i ndryshuar;

VKM nr. 187, datë 08.03.2017, *"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë"*, i ndryshuar;

VKM nr. 165, datë 02.03.2016, "*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar.

- Standardet e auditimit. ISSAI 100 *"Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*" etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e

procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[3]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u

[3] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Me shkresën nr.734/2, datë 06.08.2026, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjor gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.
Auditimi në subjektin "Bashkia Vau i Dejës", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Në këtë subjekt, *u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që në gjykimin profesional të pavarur janë materiale por jo të përhapura, etj.*
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

2. Përshkrimi i Auditimit, Sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditi i Brendshëm.

-Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: "Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike", u audituа dokumentacioni si më poshtë:
1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*", i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;

6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Vau i Dejës, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *"Mjedisi i kontrollit", "Menaxhimi i riskut", "Aktivitetet e kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi"* si dhe *"Monitorimi",* në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 "*Për disa shtesa dhe ndryshime*", ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri- tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2025, rezultoi se:

1. Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Vau i Dejës në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se Bashkia Vau i Dejës ka miratuar Rregulloren e Brendshme për vitin 2025 me Vendimin nr. 23, datë 26.06.2025 të Kryetarit të Bashkisë, "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Vau i Dejës dhe të Njësive Administrative". Në këtë dokument janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit në përputhje me strukturën organizative.
Në Bashkinë Vau i Dejës është miratuar kodi i etikës me Vendimin nr. 23, datë 26.06.2025 të Kryetarit të Bashkisë.
Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore.
Rregullorja e Brendshme është e afishuar në faqen zyrtare të Bashkisë.
Bashkia ka procedura të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave.
-Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për vitin 2025, Bashkia ka përcaktuar procedura për mbrojtjen ndaj sinjalizuesve me Urdhrin e Titullarit nr.555 datë 16.7.2025 dhe ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion. Gjithashtu konstatohet se ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.
Gjatë vitit 2025 nuk janë marrë masa disiplinore.
Bashkia vlerëson performacën e personelit nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës.

Parimi 2-Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohen se nuk ka raportime periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB.

Nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Në Rregulloren e Brendshme me Vendimin nr. 23 datë 26.06.2025 është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra dhe të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve.

Për periudhën e aktivitetit të vitit 2025, nëpërmjet shkresës nr.1825/2 prot., datë 19.03.2026 është dërguar pranë MFE-së "Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm", si dhe "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm" dhe "Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon", për vitin e mëparshëm.

Në raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025, citohet se: Në lidhje me masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit theksojmë se janë miratuar prioritetet e investimeve bazuar në analizën e faktorëve që kanë impakt më të madh në komunitet.

Për sa trajtuar më sipër, rezulton se në formatin e këtij raporti nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", Shtojca nr. 2. E konkretisht:

-Vlerësimin e sisemit të MFK-së në të cilën përfshihet:

Gjendja aktuale e sistemit të MFK-së; objektivat e përmbushura gjatë periudhës së raportimit si dhe vlerësimin i cili duhet të paraqitet për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus kryesisht tek: mjedisi i kontrollit; vendosja e objektivave; identifikimi i ngjarjeve, vlerësimi i riskut; përgjigjja ndaj riskut; aktivitetet e kontrollit; informacioni dhe komunikimi; monitorimi.

-Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilën përfshihet:

Gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen në të cilën përfshihet:

Masat e marra nga titullari dhe vetë nëpunësi autorizues gjatë vitit raportues për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përmbushjen e objektivave dhe plan veprimet për të ardhmen bazuar në rekomandimet auditit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe menaxherët e njësisë.

-Rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në të cilën përfshihet:
Rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm, për ndjekje të mëtejshme nga njësitë qendrore të harmonizimit të Ministrisë së Financave.
Pjesë e shkresës përcjellëse nr. 1825/2 prot., datë 19.03.2026, është edhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.
Bashkia nuk ka hartuar Planin e Menaxhimit të risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.
Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 – Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre.
Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
Institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme të miratuar me Vendimin nr. 23, datë 26.06.2025, "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Vau i Dejës dhe të Njësive Administrative" e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive.
Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PPV-ve, si dhe në Relacionin e Buxhetit. PPV është i publikuar në faqen web të bashkisë https://vauidejes.gov.al/.
Me Vendimin nr.859/1 prot., datë 06.01.2025, Prefektura e Qarkut Shkodër, "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës, Institucioneve të varësisë dhe të Njësive Administrative për vitin 2025" është miratuar struktura e përbërë nga 443 punonjës, ndër të cilat 137 nëpunës civilë.

- Struktura organizative e bashkisë

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:
Funksionet politike: Kryetari; Z/Kryetarët; Administratoret; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.
Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:
a. Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
b. Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie
c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori
d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	**443**	Nëpunës Civilë	**137**
		Nëpunës me kontratë	**306**
Numri i të punësuarve me kontratë provizore		-	-
Vende vakante		-	

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar 22 punonjës të rinj. Në dosjet e personelit, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.

Bashkia Vau i Dejës ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Vau i Dejës.

Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar 22 punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Vau i Dejës. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, pavarësisht se nuk ka një plan vjetor rekrutimi.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (punësimin) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:

1-Për punësimin e z. S. Gj, i punësuar me Urdhrin nr. 436 datë 01.07.2025, "Për emërim në Detyrë" i Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin "Punonjës Mirëmbajtje në Shkolla pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse", nga verifikimi i dosjes së personelit nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

2-Për punësimin e z. K. F, i punësuar me urdhrin nr. 436 datë 01.07.2025, "Për emërimin në Detyrë" i Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin "Specialist", pranë Sektorit të Mbrojtjes, Parandalimit dhe Mbulimit të Terrenit, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton e dokumentuar nga ana e Bashkisë Vau i Dejës, të jetë zhvilluar një procedurë konkurimi e hapur për këtë pozicion pune.

Si konkluzion, punësimi pranë Bashkisë Vau i Dejës i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Vau i Dejës.

Për sa më sipër, Bashkia Vau i Dejës ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R.Sh., ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.
Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 102 datë 27.02.2025, *"Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik" (GMS)* Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje 16 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; Udhëzimin nr.16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit"; "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.

2. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.
Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2025-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 05 datë 15.01.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor për vitin 2025". *Ky dokument nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë.*
Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), por objektivat e parashikuara në buxhetin vjetor kanë si bazë PBA-në. Rezulton se objektivat e miratuara i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare.
Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.
Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. *Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.*

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se nuk ka sistem të Kontrollit të Brendshëm. *Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me,* Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR"; "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr.108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

3. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

Në zbatim të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.).
Në zbatim të Udhëzimit nr.01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të Prokurimit Publik është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.
Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.
Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.
Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. *Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.*

Parimi 12 –Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.
Bashkia ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. *Ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.*

- Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi"; "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

4. Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj*.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.

B*ashkia përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.* Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2; "Manualin për menaxhimin financiar dhe

kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

5. Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm.

Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

NJAB ka hartuar planin strategjik, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr. 6277/1 prot., datë 15.10.2024, të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2025.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1; "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr.108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Përsa i përket sistemit të MFK: Bashkia ka ngritur një sistem jo efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar planet vjetore të punës.

- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.

-Dosjet personale të punonjësve kanë disa mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, vlerësimet periodike të punonjësve dhe formularët e përshkrimeve të punës. Punësimi i 2 punonjësve në kushtet e mosplotësimit të kritereve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Për sa më sipër mban përgjegjësi: znj. Xh. K, Drejtore e Burimeve Njerëzore.

III.1.2. Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015, datë 20.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

"Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike", është ngritur dhe funksionon Sektori i Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Vau i Dejës, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

NJAB, përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 73, datë 23/12/2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Vau i Dejës, institucioneve të varësisë dhe Njësitë Administrative për vitin 2025", duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës i Auditit të Brendshëm znj. A. P dhe 2 (dy) specialistë auditi, znj. S. Ll, e certifikuar si audituese e brendshme, dhe z. D. D i pacertifikuar si auditues i brendshëm.

Tabela nr. 1; Struktura e njësisë AB për vitin 2025

Nr.	Periudha	Funksioni	Arsimi bazë	Niveli i diplomës	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2025							
1	A. P	Përgjegjëse	Juriste	Master Shkencor	9	7	2023	Po
2	S. Ll	Specialist	Ekonomiste	Master Shkencor	6	5	2023	Jo
3	D. D.	Specialist	Ekonomist	Master Profesional	3	2	x	Jo

Burimi: NJAB Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo audituesi duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikat e reja të auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, është krijuar nga Bashkia Vau i Dejës.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"i ndryshuar, neni 12, pika "b", i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: "Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike"; neni 13, shkronja "b" i nenit 23 të këtij ligji" dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit".

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"* ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Vau i Dejës e cila është miratuar nga

titullari me shkresën nr.389 prot., datë 24.06.2025, dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016".

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.
Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:
"Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm….."
Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.
Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar Plani Strategjik 2025-2027 i cili është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr.6277/1 prot., datë 15.10.2024.
Plani Strategjik dhe Plani Vjetor janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, me shkresën nr. 6277/2 prot., datë 15.10.2024, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

<u>Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2025</u>
Nga auditimi rezultoi se:
Në planin vjetor të auditimit për vitin 2025, miratuar me shkresën nr.6277/1 prot., datë 15.10.2024, janë programuar për auditim, drejtori brenda strukturës së Bashkisë dhe institucione në varësi të saj.
Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, Njësia e Auditimit të Brendshëm janë planifikuar për t'u kryer 6 auditime kundrejt 8 auditimeve të programuara, pra plani vjetor është realizuar 75%, nga të cilat 8 auditime paraqiten në statusin *"Angazhime të përfunduara"* pasqyruar si më poshtë:
Tabela nr.2;

Nr.	Planifikuar	Nr.	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr.	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financa	IT	Kombinim		
1	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore	1	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore	1	1					1	
2	Sektori i Prokurimeve Publike	1	Sektori i Prokurimeve Publike	1	1					1	
3	Sektori i Burimeve Njerëzore	1	Sektori i Burimeve Njerëzore	1	1					1	
4	Policia Bashkiake	1	Policia Bashkiake	1	1					1	
5	Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1	Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1					1	1	
6	Detyrimet e Prapambetura	1	Detyrimet e Prapambetura	1					1	1	
7	Sektori i Aseteve	1	Sektori i Aseteve	1	1					1	
8	Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve	1	Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve	1						1	
		8	**Totali**	**8**	**5**	**0**	**0**	**0**	**2**	**8**	

Burimi: NJAB Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 88/2 prot., datë 13.02.2026.
Nga auditimi i raportimit për vitin 2025, rezulton se janë dhënë 38 rekomandime gjithsej, të cilat janë të karakterit organizativ. Rekomandime të pranuara janë 24 dhe 14 të papranuara prej të cilave 24 rekomandime janë zbatuar.
Tabela nr.3;

Nr.	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2025	38	24	24	0				0
TOTALI		**38**	**24**	**24**	**0**				**0**

Burimi: NJAB Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konstatim: Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Vau i Dejës, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit pika 3.1.3 ku citohet:
"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit"

<u>Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB</u>
Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2025, zgjodhi të auditojë dosjen e cila është vlerësuar nga DAB me nivel të mesëm dhe të lartë risku siç është:
- Dosja e auditimit të kryer në Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
- Dosja e auditimit e performancës dhe përputhshmërisë për subjektin, Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Objektivi kryesor i subjektit të audituar konsiston në: Zbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave ligjore nga punonjësit e Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:
- Të ndihmojë subjektin që do të auditohet në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit.

Gjetja e konstatuar:
I. Nga auditimi u konstatua se nga kjo drejtori nuk është bërë identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, në lidhje me programimin dhe realizimin e detyrave si dhe mungon Regjistri i Riskut.
Rekomandimi i lënë:
"Të bëhet identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut, në lidhje me programimin dhe realizimin e detyrave, si dhe të hartohet Regjistri i Riskut konform Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
II. Nga auditimi u konstatua se aktiviteti i Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi është mbështetur në rregulloren e brendshme në të cilën janë përcaktuar detyrat e personelit të këtij sektori, por kjo rregullore nuk është përditësuar me ndryshimet e fundit.
Rekomandimi i lënë:
"Nga Sektori *i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi të përpunohet dhe të përditësohet rregullorja e brendshme për stafin e saj. Si dhe të përcaktohen detyra të qarta, konkrete, të plota dhe praktike, për të mundësuar kontrollin dhe menaxhimin e realizimit të objektivave".*
IV. Sipas informacionit verbal dokumentacioni për shpenzimet e kryera në Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ndodhet në drejtorinë e burimeve ekonomike, aty ku finalizohet veprimi.
Rekomandimi i lënë:
"Një kopje e dokumentacionit të mbahet nga sektori i gjelbërimit, për të dokumentuar më mirë punën e tij".
Konstatim:

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushë të audituar;
-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm , si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.
Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vau i Dejës ka hartuar *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* i cili rezulton të jetë i miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 6277/2 prot., datë 15.10.2024.
Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Vau i Dejës në përputhje me Ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit" e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr.555 datë 16.7.2025.

Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet. Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr.114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar;
-Për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025, nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Vau i Dejës, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;
-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
- NjAB në Bashkinë Vau i Dejës nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme".*

Për sa më sipër mban përgjegjësi: znj. A. P, Përgjegjëse e Sektorit të Njësisë së auditit të brendshëm.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2025.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për vitin 2025 për përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.84 datë 23.12.2024, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.860/1 prot., datë 06.01.2025. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin në infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Vau i Dejës.
Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:
a. Mbështetja për përmiresimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.
b. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal dhe kombëtar.
c. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.
d. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet iniciativave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 "*Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore*". Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*
Programi i të ardhurave për vitin 2025 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 1, datë 15.01.2025, i ndryshuar.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025 është 1,135,388 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2025, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2025, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.4; PBA për periudhën 2025-2027 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Vau i Dejës

Nr.	Kodi	Programi	PBA Plan viti 2025	Buxheti vjetor 2025 Plani i Rishikuar	Realizimi i periudhës progesiv	Diferenca
			1	2	3	4= (3-2)
1	1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	231,566,231	419,586,545	212,827,935	-206,758,610
2	3140	Policia Bashkiake	16,284,279	23,072,837	13,018,553	-10,054,284
3	3280	Mbrotja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	66,456,195	141,580,493	45,118,685	-96,461,808
4	4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	3,674,347	27,176,146	1,032,616	-26,143,530
5	4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	-	600,000	-	
6	4240	Menaxhimi i Infrastruktuës së Ujitjes dhe Kullimit	33,296,933	71,354,101	30,542,392	-40,811,709
7	4520	Rrjeti Rrugor Rural	75,497,296	409,134,483	151,964,924	-257,169,559
8	4260	Administrimi i pyjeve	11,508,000	35,562,813	21,229,056	-14,333,757
9	4910	Fond rezervë	250,000	2,352,079		
10	4940	Fondi i kontigjencës	250,000	9,976,796		
11	4960			138,792		
12	5100	Menaxhimi i Mbetjeve	28,626,860	78,894,303	24,835,806	-54,058,497
13	6140	Planifikimi Urban Vendore	10,000,000	11,196,840		
14	6260	Shërbimet Publike Vendore	54,320,930	80,907,771	43,549,126	-37,358,645
15	6370	Furnizim me Ujë	8,296,000	23,502,897		
16	7220	Shërbimet e kujdesit parësor	500,000	17,387,746		
17	8130	Sport dhe Argëtim	4,521,857	15,979,674	285,600	-15,694,074
18	8220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	7,178,890	23,032,783	4,404,863	-18,627,920
19	9120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	95,718,555	181,168,109	96,406,903	-84,761,206
20	9230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	21,012,229	58,465,619	22,172,230	-36,293,389
21	10430	Përkujdesi Social	415,021,202	62,595,951	19,165,036	-43,430,915
22	10661	Strehimi Social	2,374,666	11,324,978	6,820,263	-4,504,715
23	6220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane		57,271,737	57,271,737	0
24	10430	Përkujdesi Social		307,398,664	301,671,640	-5,727,024
25	9120	Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor		27,173,869	24,802,188	-2,371,681
26	9240	Arsimi parauniversitar		4,146,000	4,146,000	0
27	9240	Arsimi parauniversitar		531,480		
28	10910	Emergjencat Civile		10,503,492	9,803,375	-700,117
29	10910	Emergjencat Civile		30,000,032	30,000,000	-32
30	6190	Strehimi Social		4,897,397	4,897,397	0
31	1170	Gjendja Civile		7,604,866	7,087,607	-517,259
32	1620	Planifikim dhe Administrim (shpërblime komisionere)		2,334,740	2,334,738	-2
Totali i shpenzimeve të njësisë			**1,086,354,470**	**2,156,854,033**	**1,135,388,670**	**1,021,465,363**

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar, Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2025-2027, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 1,021,465 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për "Rrjeti Rrugor Rural", "Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi", "Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile", "Policia Bashkiake" dhe "Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin".

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2025-2027 Bashkia Vau i Dejës ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.5; Planifikimi i të ardhurave

000/lelë

Përshkrimi	Planifikimi 2025
Të ardhura tatimore	81,207
Të ardhura jotatimore	94,977
TOTAL	**176,184**

Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar, Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në veçanti nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2025-2027, u konstatua se:
-Për PBA 2025-2027 janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Vau i Dejës, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore";
-Për PBA 2023-2025 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat "a-h" të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Vau i Dejës, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë proçesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Vau i Dejës, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);
-Për PBA 2025-2027 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"*, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"* si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027".

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.
Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.
Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.
Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vau i Dejës dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor

për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.
Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Vau i Dejës ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Vau i Dejës, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër.
Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr.6; Planifikimi i buxhetit për vitin 2025, Bashkia Vau i Dejës

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2025	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
	Të ardhurat		
1	*Të ardhura e veta të trashëguara sipas rakordimeve me thesarin*	974,763,782	
2	*Të ardhura e vitit ushtrimor*	176,185,731	
3	*Transferta e pakushtëzuar*	372,589,778	
4	*Transferta specifike*	146,417,961	
5	Paga (600)		521,964,130
6	Sigurime (601)		85,408,890
7	Shpenzime (602)		349,334,950
8	Shpenzime (604)		111,462,527
9	Shpenzime (609)		10,159,842
10	Fondi Veçantë		
11	Investime (230 +231)		588,349,484
12	Transferta 606		1,463,341
13	Shpenzime (603)		1,814,088
Totali i buxhetit		**1,669,957,252**	**1,669,957,252**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki + Njësitë e Varësisë) për vitin 2025 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,669,957,252 lekë**.

Përgjatë vitit 2025, kanë ndodhur 30 ndryshime[4] buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.
-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.7; Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Kodi	Programi	Plani progresiv	Fakti	%
1	1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	419,586,545	212,827,935	51%
2	3140	Policia Bashkiake	23,072,837	13,018,553	56%
3	3280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	141,580,493	45,118,685	32%
4	4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	27,176,146	1,032,616	4%
5	4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	600,000		0%
6	4240	Menaxhimi i Infrastruktuës së Ujitjes dhe Kullimit	71,354,101	30,542,392	43%
7	4520	Rrjeti Rrugor Rural	409,134,483	151,964,924	37%
8	4260	Administrimi i pyjeve	35,562,813	21,229,056	60%
9	4910	Fondi rezervë	2,352,079		0%
10	4940	Fondi i kontigjencës	9,976,796		0%

[4]Pasqyruar në tabelën nr.3 kapitulli Anekse;

11	4960		138,792		0%
12	5100	Menaxhimi i Mbetjeve	78,894,303	24,835,806	31%
13	6140	Planifikimi Urban Vendore	11,196,840		0%
14	6260	Shërbimet Publike Vendore	80,907,771	43,549,126	54%
15	6370	Furnizim me Ujë	23,502,897		0%
16	7220	Shërbimet e kujdesit parësor	17,387,746		0%
17	8130	Sport dhe Argëtim	15,979,674	285,600	2%
18	8220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	23,032,783	4,404,863	19%
19	9120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	181,168,109	96,406,903	53%
20	9230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	58,465,619	22,172,230	38%
21	10430	Përkujdesi Social	62,595,951	19,165,036	31%
22	10661	Strehimi Social	11,324,978	6,820,263	60%
23	6220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	57,271,737	57,271,737	100%
24	10430	Përkujdesi Social	307,398,664	301,671,640	98%
25	9120	Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor	27,173,869	24,802,188	91%
26	9240	Arsimi parauniversitar	4,146,000	4,146,000	100%
27	9240	Arsimi parauniversitar	531,480		0%
28	10910	Emergjencat Civile	10,503,492	9,803,375	93%
29	10910	Emergjencat Civile	30,000,032	30,000,000	100%
30	6190	Strehimi Social	4,897,397	4,897,397	100%
31	1170	Gjendja Civile	7,604,866	7,087,607	93%
32	1620	Planifikim dhe Administrim (shpërblime komisionere)	2,334,740	2,334,738	100%
Totali i shpenzimeve të njësisë			**2,156,854,033**	**1,135,388,670**	**53%**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:
Për vitin 2025 realizimi i buxhetit është në nivelin 53%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është "Menaxhimi i Mbetjeve Urbane", "Arsimi Parauniversitar", "Emergjencat Civile, dhe "Strehim Social;
Programi me realizimin më të ulët është "Sport dhe Argëtim", "Mbështetje për zhvillim Ekonomik" dhe "Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile;

<u>Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.</u>

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Shkodër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar proçedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Shkodër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuara nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2025-2027, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.8, Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2025

Art.	Emërtimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	523,800,836	342,647,226	65%
601	Sigurime Shoqërore	86,223,346	57,186,567	66%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	354,683,210	116,303,270	33%
603	Subvencione	1,814,088	-	0%
604	Transferta Korente të Brendshme	113,644,032	9,841,636	9%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	320,853,336	313,619,510	98%
609	Fondi i kontigjencës (04910 & 04940)	10,159,842	-	0%
230	Kapitale të Patrupëzuara	35,675,281	10,007,958	28%
231	Kapitale të Trupëzuara	710,000,062	285,782,503	40%
	TOTAL	**2,156,854,033**	**1,135,388,670**	53%

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2025 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 53%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 "Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ" duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, transferta korente të brendshme si dhe realizimin më të ulët e kanë mallra dhe shërbime të tjera. Vihet re se për vitin 2025 art. (602) mallra dhe shërbime të tjera paraqiten 33 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.

Tabela nr.9; Buxheti sipas burimeve të financimit 2025

Nr.	Emërtimi	Viti 2025						
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Fakti sipas aktrakordimit	Të ardhurat veta	Trans. pakushtëz Spec.	Transf. Kushtëzuar	Transf. Kushtëz për Inv.	Gjithsej
			1	2	3	4	5	6 = (1+4+5)
1	Paga (600)	360,496,335	336,686,544	-	111,878,909	5,960,682		342,647,226
2	Sigurime (601)	60,382,414	56,195,162	-	18,683,778	991,405		57,186,567
3	Shpenzime (602)	139,452,366	113,968,532	42,421,173	11,159,027	2,334,738		116,303,270
4	Shpenzime (604)	27,854,822	5,356,763	2,200,851	-	4,483,375		9,841,636
5	Shpenzime (603)	-	-	-	-			
6	F. Rezervë (604)	250,000	-	-	-			
7	Fondi i kont. (609)	250,000	-	-	-			
8	Inv. (230 +231)	106,507,533	173,499,139	120,663,318	-		122,291,322	295,790,461
9	Transferta (606)	391,161,000	7,666,350	4,231,390	-	305,953,160		313,619,510
	Totali	**1,086,354,470**	**693,372,490**	**169,516,732**	**141,721,714**	**319,723,360**	**122,291,322**	**1,135,388,670**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar dhe specifike, në vlerën 319,723,360 lekë ose 28 % të fondeve të shpenzuara për vitin 2025, për të vijuar me transfertën e pakushtëzuar në vlerën 141,721,714 lekë ose 12.5 % të fondeve sipas burimit të financimit për të vijuar me transfertën e kushtëzuar për investime në vlerën 122,291,322 lekë ose 10.8 % dhe të ardhurat e veta në vlerën 169,516,732 lekë ose 15 % të fondeve sipas burimit të financimit.

Transferta e kushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar dhe specifike për vitin 2025 është realizuar në vlerën 319,723,360 lekë, ose 28 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar dhe specifike, e zënë shpenzimet për Transferta për familje dhe individ dhe investime.

Transferta e pakushtëzuar specifike.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2025 është realizuar në vlerën 141,721,714 lekë, ose 12.5 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2025 është realizuar në vlerën 169,516,732 lekë, ose 15 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2025, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime dhe shpenzime operative.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Me miratimin e buxhetit për vitin 2025 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2025 është planifikuar në masën 1,000 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Bashkia Vau i Dejës nga fondi rezerve/dhe kontigjencës nuk janë përdorur gjatë vitit.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.

Nga Bashkia Vau i Dejës është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 22,807,739 lekë dhe është realizuar në vlerën 3,001,987 lekë, dhe mbetet e pa përdorur shuma 19,805,752 lekë. Këto fonde janë përdorur për riparim çatish të dëmtuara si dhe riparim banese nga djegiet nga zjarret, konkretisht:

-VKB nr. 17 datë 26.02.2025 me shprehje ligjshmërie nr. 171/1 prot., datë 11.03.2025, dhënie e ndihmës financiare në vlerën 48,000 lekë familjes së z. Xh. K. Gj, që i është dëmtuar banesa si pasojë e erërave me intensitet të lartë.

-VKB nr. 05 datë 29.01.2025 me shprehje ligjshmërie nr. 110/1prot., datë 12.02.2025, dhënie e ndihmës financiare në vlerën 1,358,076 lekë familjes së z. G. O. M, që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë.

-VKB nr. 06 datë 29.01.2025 me shprehje ligjshmërie nr. 111/1 prot., datë 12.02.2025 dhënie e ndihmës financiare në vlerën 68,500 lekë familjes së z. A. C. Et-h, që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë.
-VKB nr. 07 datë 29.01.2025 me shprehje ligjshmërie nr. 112/1 prot., datë 12.02.2025 dhënie e ndihmës financiare në vlerën 749,425 lekë familjes së z. M. M. D, që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë.
-VKB nr. 40 datë 25.07.2025 me shprehje ligjshmërie nr. 499/1 prot., datë 01.08.2025, Të tjera transferta tek individët, dhënie e ndihmës financiare në vlerën 777,986 lekë familjes së z. A. J, që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë.

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Vau i Dejës.
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Vau i Dejës përgjatë periudhës 2025 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

Realizimi i Investimeve.
Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele jo të mira në vitin 2025, konkretisht në masën 28 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vau i Dejës në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "a" në nenin 5, në Ligjin nr.68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*;
Neni 47 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.

Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.
Në zbatim të nenit 48 "*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*" të Ligjit 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, Udhëzimin nr.22 datë 30.07.2018 "*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*", si dhe nenin 44[5], të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*". Për vitin 2025 Bashkia Vau i Dejës me shkresën nr.3119 prot., datë 03.06.2025, ka përcjellë në MF raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2025, me shkresën nr.5558 prot., datë 30.09.2025 ka përcjellë në MF raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e dytë të vitit si dhe me shkresën nr.1230 prot., datë 27.02.2026 ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe në Këshillin Bashkiak raportin vjetor të monitorimit të buxhetit.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.
Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Vau i Dejës, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MF.
Me fondet buxhetore të vitit 2025, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës sipas fondeve të çelura

[5] Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe instuticionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.
Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2025-31.12.2025 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2025.

Tabela nr.10; Detyrimet e prapambetura për periudhën 2025

Detyrime	Detyrimi në 31.12.2024	Detyrimi i krijuar në 01.01.2025-31.12.2025	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2025	Mbetja e Detyrimeve në 31.12.2025
Investime	398,880	5,056,432	5,455,312	4,267,960	1,187,352
Investime (nga ministritë e linjës)	57,660,656	3,870,553	61,531,209	61,142,290	388,919
Investime nga FZHSH	-	-	-	-	-
Mallra dhe shërbime	-	8,329,817	8,329,817	8,329,817	-
Vendime gjyqësore	3,342,860	-	3,342,860	-	3,342,860
Të tjera	-	-	-	-	-
Totali	**61,402,396**	**17,256,802**	**78,659,198**	**73,740,067**	**4,919,131**
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2025					**307,456,975**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Vau i Dejës ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2025, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.
-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2025, përcjellë në MF me shkresën nr. 1227 prot., datë 27.02.2026, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës ndaj palëve të treta raportuar në MF është në vlerën 4,919,131 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore pasqyruar në tabelën më poshtë:
Për efekt krahasimi dhe mosrakordimit të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2025 për sa raportuar nga Bashkia, sa paraqitur në pasqyrat financiare dhe SIFQ tabela si më poshtë:

Tabela nr.11; Situata Financiare për vitin 2025

Nr.	Emërtimi	Stokun vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	-		
a	**Hua afatgjatë**	-		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	**Hua afatshkurtër**	-		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kreditë furnitorëve			
II	**Detyrime (a+b+c)**	**4,919,131**		**0.71%**
a	**Shpenzime korrente**	-		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	**Shpenzime kapitale**	**1,576,271**		
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	**Vendime gjyqësore**	**3,342,860**		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	**Totali (I+II)**	**4,919,131**	**693,373,988**	**0.71%**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:
"Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta", nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrata, faturë ose sipas ligjit".

"Detyrimet e prapambetura regjistrohen në llogarinë ekonomike nr. 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura"[6].
"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2025, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr. 486 në debi të llogarisë nr. 467 "Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2025"[7].
-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 8 % ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2025.
Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, **ç'ka do të thotë se Bashkia Vau i Dejës në fund të vitit 2025 rezulton në një situatë normale.**

Detyrimet nga vendimet gjyqësore
Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2025 janë në vlerën 3,359,878 lekë ose rreth 68.3 % mbi totalin e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2025 ka kryer likuidime në vlerën 1,358,099 lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Në fund të vitit 2025 Bashkia Vau i Dejës ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 307,456,975 lekë, të cilat mund t'i përdorte për likuidimin e plotë të vendimeve gjyqësore si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit/personave që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Vau i Dejës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".

Shpronësimet për interes publik.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar rezultoi se përgjatë vitit 2025 nuk ka pasur detyrime për shpronësime të krijuara në vitin 2025 apo nga vite të mëparshme dhe të palikuiduara.

Faturat e palikuiduara brenda afatit 60 ditor.
Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **60 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Shkodër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 29 raste për vlerën 20,605,376 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë, dhe në Kapitullin "Anekse".

Tabela nr.12; Përmbledhëse e faturave për vitin 2025

Artikulli	Sasia	Viti 2025/lekë
230-231	7	9,651,939
602	22	10,953,437
Totali	**29**	**20,605,376**

Burimi: Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2025 janë 7 fatura të palikuiduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 4,919,131[8] lekë.
-Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 60 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni

[6] Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme".
[7] Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar".
[8] Analitikisht pasqyruar në Anekse.

për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, i ndryshuar.

Konkluzion i përgjithshëm:
- Buxheti i Bashkisë Vau i Dejës dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të Ligjit të buxhetit për vitin 2025;
- Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
- Për PBA 2025-2027 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Vau i Dejës, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Për vitin 2025 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 53%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 "Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ" duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, transferta korente të brendshme si dhe realizimin më të ulët e kanë mallra dhe shërbime të tjera. Vihet re se për vitin 2025 art. (602) mallra dhe shërbime të tjera paraqiten 33 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.
-Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2025 janë në vlerën 3,359,878 lekë ose rreth 68.3 % mbi totalin e detyrimeve të raportuara.
- Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2025 janë në vlerën 3,359,878 lekë ose rreth 68.3 % mbi totalin e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2025 ka kryer likuidime në vlerën 1,358,099 lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.
-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Vau i Dejës, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 29 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 20,605,376 lekë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: znj. E. T, Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.5. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive për vitin buxhetor.
Në zbatim të pikës III.2.2.5 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- *Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2025*
- *Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2025.*
- *Regjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.*
- *Rakordimet me agjentët tatimor.*
- *Evidenca e planifkimimit të ardhurave.*
- *Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.*
- *Regjistrat e subjekteve debitore në 31.12.2025.*

- *Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.*

Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

-*Dokumentacioni i shqyrtuar për auditimin e të ardhurave.*

Në auditimin e kryer mbi burimin e krijimit të ardhurave dhe përdorimi i tyre u audituan dokumentacioni i paraqitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si: Evidencat analitike e llogarive debitorë për taksat dhe tarifat vendore, akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve, administrimi i aseteve, procedura e lëshimit të licencave dhe autorizimeve, si dhe dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale dhe për strukturën organike.

-Baza ligjore

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKB-në nr.99, datë 24.12.2024, konfirmuar dhe nga Prefekti i Qarkut Shkodër me nr.4821/3 prot., datë 15.01.2025, *"Për Sistemimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau i Dejës"* ku përfshin dhe Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 *"Për Taksat Kombëtare"*, i ndryshuar. Përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, u auditua dokumentacioni i paraqitur nga Sektori i Tatim Taksave, për periudhën 01.01.2025 deri në 31.12.2025.

-Struktura e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Bashkia Vau i Dejës.

Për vitin 2025 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr. 83, datë 23.12.2024, *"Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vau i Dejës",* është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 859/1 datë 06.01.2025, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, si dhe me inspektorët e taksave, për çdo Njësi Administrative, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore ka në përbërjen e saj, 1 përgjegjës sektori dhe 7 specialistë. Punonjësit e sektorit të taksave dhe tarifave vendore janë me status te nëpunësit civil, pasqyruar në kapitullin Anekse.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, për vitin 2025 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Vau i Dejës nga taksat dhe tarifat vendore.

-Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Vau i Dejës.

-Paketa fiskale për vitin 2025 është miratuar me VKB nr. 01, datë 15.01.2025, i ndryshuar, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.108/1 prot., datë 12.02.2025.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Vau i Dejës, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 45 lloje taksash dhe tarifash. Për vitin 2025 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Vau i Dejës dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

1.Biznes;
2.Ambulant;
3.Familjar;
4.Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përjashtuar institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:
-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.
-Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Tabela 13; Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr.	Lloji	2025
1	Biznesi i Madh	128
2	Biznesi i Vogël	530
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	2
4	Institucione	2
	Total	**650**

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Shkodër parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025 paraqitet në mënyrë analitike në kapitullin Anekse.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Vau i Dejës paraqitet në masën 91%, nga 176,185 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 160,949 mijë lekë (15,236 mijë lekë më pak nga plani).
Në krahasim me vitin 2024 kemi rritje të ardhurave të arkëtuara me 4,750 mijë lekë më shumë.

Me tejkalim paraqiten zërat, si:
1- 2 % tatimi mbi të ardhurat personale, paraqitet me realizim në masën 116%, ku nga vlera e planifikuar prej 10,300 mijë lekë është arkëtuar vlera 11,944 mijë lekë.
2- Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel nga 103 mijë lekë është arkëtuar vlera 391 mijë lekë ose 380 %, pra Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës nuk ka bërë planifikim të saktë, duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2024 e cila është planifikuar në vlerën 103 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 870 mijë lekë;
3- Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel nga 103 mijë lekë është arkëtuar vlera 391 mijë lekë ose 380%.
4- Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, paraqitet me realizim në masën 119%, ku nga vlera e planifikuar prej 19,288 mijë lekë është arkëtuar vlera 22,894 mijë lekë.
5- Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota), paraqitet me realizim në masën 110%, ku nga vlera e planifikuar prej 30,602 mijë lekë është arkëtuar vlera 33,599 mijë lekë.
6- Të ardhura nga tarifa për gjelbërimin nga biznesi paraqitet me realizim në masën 108%, ku nga vlera e planifikuar prej 2,197 mijë lekë është arkëtuar vlera 2,381 mijë lekë, etj.

Në tërësinë e taksave dhe tarifave të mësipërme që janë realizuar më pak, përmendim disa prej tyre, të cilat janë më të rëndësishmet, pasi përbëjnë burimin kryesor dhe të qëndrueshëm të ardhurave të Bashkisë Vau i Dejës, konkretisht:
- Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, planifikuar në vlerën 44,803 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 26,151 mijë lekë ose në masën 58%.
- Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore, planifikuar në vlerën 22,142 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 7,251 mijë lekë ose në masën 33%.

- Të ardhura nga tarifa e pastrimit nga familjet, planifikuar në vlerën 16,078 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 7,611 mijë lekë ose në masën 47%.
- Të ardhura nga tarifa e ndriçimin publik nga familjet, planifikuar në vlerën 6,015 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 3,353 mijë lekë ose në masën 56%.

Ky rezultat tregon punë të pamjaftueshme të Bashkisë Vau i Dejës në mbledhjen e tarifës së pastrimit për familjet në qytet dhe në NJA.

-Për vitin 2025 peshën kryesore të të ardhurave e zënë të ardhurat nga të ardhurat nga tarifat vendore me 41,786 mijë lekë, ose 26 % ndaj totalit të ardhurave të realizuara, duke vijuar me të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota) në vlerën 33,599 mijë lekë ose 20.8% ndaj totalit, të ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave në vlerën 27,820 mijë lekë, ose 17.2% ndaj totalit, të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme në vlerën 26,151 mijë lekë, ose 16.2% ndaj totalit etj.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga ky Sektor nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2025 me qëllim pasqyrimin real të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Vau i Dejës që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçite në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat "a" dhe "e" të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore*".

<u>Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Vau i Dejës sipas kategorive të tyre.</u>

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Tabela nr.14;

Nr.	Emërtimi Njësive	Gjendja në fund vitit 2024	Pakësime 2025	Shtesa gjatë vitit 2025	Gjendja në fund vitit 2025
305	**BIZNESE**	**34,066,218**	**2,904,505**	**4,684,004**	**35,845,717**
66	Nj.A Vau-Dejës Qendër	8,308,502	971,215	1,233,536	8,570,823
209	Nj.A Bushat	23,605,212	1,639,320	2,647,747	24,613,639
15	Nj.A Hajmel	1,568,490	86,351	515,283	1,997,422
13	Nj.A Temal	533,298	207,619	278,342	604,021
1	Nj.A Vig-Mnele	43,894	-	9,096	52,990
1	Nj.A Shllak	6,822	-	-	6,822
10857	**FAMILJARE**	**250,073,099**	**71,830,035**	**38,845,889**	**217,088,953**
2931	Vau i Dejës Qendër	83,573,365	25,390,563	12,187,228	70,370,030
4853	Nj.A Bushat	111,565,852	34,603,232	19,094,962	96,057,582
1160	Nj.A Hajmel	43,006,832	10,140,728	6,493,890	39,359,994
611	Nj.A Temal	4,459,298	260,112	446,460	4,645,646
710	Nj.A Vig-Mnele	5,278,974	1,430,027	400,786	4,249,733
592	Nj.A. Shllak	2,188,778	5,373	222,563	2,405,968
42	**KONTRATA QERAJE**	**42,070,937**	**30,623,976**	**41,852,691**	**53,299,652**
72	**TNI Infrastrukturë**	**2,372,241**	**187,006**	**0**	**2,185,235**
24	**Gjoba IMT**	**24,007,470**	**21,833,481**	**68,523,489**	**70,697,478**
11204	**TOTALI**	**352,589,965**	**127,379,003**	**153,906,073**	**379,117,035**

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:
Nga auditimi konstatohet se, vlera e detyrimeve në fund të vitit 2024 është **352,589,965 lekë** për taksat dhe tarifat vendore, qiratë, TNI, gjobat, kamatëvonesa etj., vlera e detyrimeve të krijuar gjatë vitit 2025 është në vlerën 153,906,073 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2025 janë në vlerën 127,379,003 lekë, gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2025 është në vlerën **379,117,035 lekë.**
Në krahasim me fundin e vitit 2024, në fund të vitit 2025 kemi rritje të vlerës debitore me 26,527,070 lekë ose 7 %, e cila mund të krijohet si rezultat i mos njoftimit në mënyrë të rregullt i individëve apo i subjekteve të cilët mund të mos jenë të vetëdijshëm për borxhin e krijuar.
Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Vau i Dejës në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.
Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Vau i Dejës paraqitet:
1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 217,088,953 lekë.
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë 2,185,235 lekë.
3. Biznese debitore në vlerë 35,845,717 lekë.
Nga auditimi konstatohet se, në fund të vitit 2025 borxhi tatimor është në vlerën 255,119,905 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës.

Pajisja me autorizime të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:
Grupi i auditimit, auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:
- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre",* i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, *"*P*ër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre",* të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;
- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika 2/9 "*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera*".
Nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Vau i Dejës dhe në Njësitë Administrative, na u vendosën në dispozicion 24 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar në kapitullin anekse:

Sipas tabelës të pasqyruar në kapitullin anekse dhe dokumentacionit ndodhur në dosjet respektive, rezulton se:
- Përgjatë vitit 2025 në Bashkinë Vau i Dejës u konstatua se 22 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve, nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktiviteti, pasqyruar si më poshtë:
1- Subjekti G. P, me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
2- Subjekti V. D, me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.

3- Subjekti V. Gj, me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
4- Subjekti N – O me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
5- Subjekti L – F. G, me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 20,000 lekë.
6- Subjekti I. Z, ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
7- Subjekti J. A, me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
8- Subjekti E, me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
9- Subjekti F-O. G, me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
10- Subjekti V. N. 2015, me adresë Hajmel, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
11- Subjekti Ç, me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
12- Subjekti G-O me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
13- Subjekti G. C. G, me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
14- Subjekti D-A me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
15- Subjekti L. G ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 20,000 lekë.
16- Subjekti V. B, me adresë Vau i Dejës, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
17- Subjekti F-P, me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
18- Subjekti S, ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
19- Subjekti A- D, ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
20- Subjekti V. 3, ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.
21- Subjekti P. P, ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.

22- Subjekti J. O, ShPK me adresë Bushat, ka ushtruar aktivitet pa licencë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 200,000 lekë.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Vau i Dejës, përgjatë vitit 2025 nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve.
- Pra sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2025, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* i ndryshuar, me VKM nr.344 datë 19.04.2017.
- Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 22 subjekte për 24 stacione shitje të karburantit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të *ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 4,040,000 lekë.*
Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e Taksave Vendore"*, i ndryshuar.
Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja "b" në pikën 1 në nenin 131 *"…nuk i paguan ato në buxhet"* të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 *"Për procedurat tatimore në RSH"*, i ndryshuar.
Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr.970, datë 2.12.2015 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"* i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.
Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. S. V, specialist i Shërbimeve Publike, z. B. L, Drejtor i Shërbimeve Publike.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:
Bashkia Vau i Dejës në fillim të vitit 2025 ka patur në total 635 subjekte tregtarë, dhe gjatë vitit ka patur 28 subjekte të cilët janë pezulluar/ç'rregjistruar dhe 44 subjekte të reja ose 16 subjekte më shumë se viti 2024, nga të cilët 519 janë biznes i vogël dhe 132 operojnë si biznes i madh.

Tabela nr.16; Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2025, paraqiten si më poshtë:

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në 31.12.2025
1	Biznes i vogël	2025	510	35	26	519
2	Biznes i madh	2025	125	9	2	132
TOTAL			**635**	**44**	**28**	**651**

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Taksat dhe tarifat e biznesit:
Në Bashkinë Vau i Dejës subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit, etj., në tabelën në vijim paraqiten detyrimet e subjekteve në fund të vitit 2025, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2025 si dhe detyrimi në fund të periudhës 2025;
Tabela nr.17; Subjektet debitore nga 01.01.2025 deri më datë 31.12.2025;

Nr.	Natyra e debitorëve	Debitor deri më 31.12.2024	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Debitor deri më 31.12.2025
1	Biznesi vogël	21,501,451	3,236,996	1,832,728	22,905,719
2	Biznes i madh	10,184,478	983,589	807,292	10,360,775

3	Kamtëvonesa deri 31.12.2024	2,380,289	463,419	264,485	2,579,223
1+2+3	Total	**34,066,218**	**4,684,004**	**2,904,505**	**35,845,717**

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Debitorët "Biznes" të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.
Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se deri në 31.12.2024 kanë qenë debitor në vlerën **34,066,218 lekë**.
Për vitin 2025 janë krijuar debitorë në vlerën 4,684,004 lekë.
-Në fund të vitit 2025 në mënyrë progresive rezultojnë debitor subjekte të kategorisë "Biznes" në vlerën 35,845,717 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës.
-Në fund të vitit 2025 në krahasim me fillimin e vitit 2024, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë "Biznes" ka ardhur në rritje.
-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes) nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vau i Dejës, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese në mënyrë shteruese për të gjithë subjektet (deri në vendosjen e barrës siguruese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

Masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit
Për vitin 2025 ka ecuri lidhur me masat shtrënguese por gjithsesi në nivele të ulëta vendosje apo ekzekutimi. Masat shtrënguese nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkakun e mos mbledhjeve të detyrimeve. Analiza dhe planet operacionale janë një hap i cili duhej dhe duhet të jetë në të ardhmen në fokus si indikator orientues për vijimin e marrjes së masave me qëllim arkëtimin e detyrimeve për secilin debitor, biznes i madh i vogël apo çdo lloj debitori. Trendi i rritjes së detyrimeve të pa paguara mbetet akoma i lartë dhe për pasojë ka sjellë të ardhura të munguara, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës, të ardhura këto që mund të përdoreshin nga Bashkia për investime në infrastrukturë dhe rritjen e përmirësimit të shërbimeve e në tërësi përmirësimin e kushteve të qytetarëve të kësaj bashkie.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e arkëtimin e borxhit u konstatua se administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve proçeduriale nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektorit të Kontrollit dhe Borxhit Tatimor, duke mos ezauruar në kohë dhe me efikasitet të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në legjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve.
Në lidhje me këtë situatë struktura e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Kontrollit dhe Borxhit Tatimor të Bashkisë Vau i Dejës për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar për pagesën e detyrimeve, janë mjaftuar vetëm më dërgimin e njoftim detyrimeve për subjektet debitorë si dhe urdhër bllokimet e llogarive të bankave të nivelit të dytë për subjektet debitore. Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) apo për vendosjen e barrës së pasurisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
Gjithashtu nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese për debitorët si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve sipas kërkesave të nenit 114, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat tatimore në R.SH"* ndryshuar me Ligjin nr.164/2014, datë 4.12.2014, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar" nenet 89-91.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. Gj. D, Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Borxhit Tatimor

Taksat dhe tarifat familjare:

Në Bashkinë Vau i Dejës familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifën e gjelbërimit, tarifën e pastrimit dhe tarifën e ndriçimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Vau i Dejës për vitin 2025 janë taksuar 9764 familje ose 144 familje më shumë krahasuar me një vit më parë ku ishin taksuar 9764 familje. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr.18; Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen

Nr.	Nj.A	Nr. Familje taksuar 2024	Nr. Familje taksuara 2025	Vlera e paguar	Familjet sipas Gjendjes Civile	Diferenca familjet e pa taksuara për vitin 2025
1	Vau i Dejës	3420	3512	5,608,033	3888	376
2	Nj.A.Bushat	4021	3931	14,895,987	6491	2960
3	Nj.A. Hajmel	1195	1260	4,053,056	2167	907
4	Nj.A.Vig-Mnele	675	689	230,662	872	183
5	Nj.A.Temal	242	257	64,498	847	590
	Nj.A. Shllak	211	259	50,275	698	439
	Total	**9764**	**9908**	**24,902,511**	**14963**	**5455**

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga të dhënat e pasqyrës, taksa e pastrimit për kategorinë familje është realizuar në masën 47% ose nga vlera e planifikuar prej 16,078, mijë lekë është arkëtuar vlera 7,611 mijë lekë.
Nga të dhënat e pasqyrës, taksa e ndriçimit publik për kategorinë familje është realizuar në masën 56% ose nga vlera e planifikuar prej 6,015 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,353 mijë lekë.
Nga të dhënat e pasqyrës, taksa e gjelbërimit për kategorinë familje është realizuar në masën 47% ose nga vlera e planifikuar prej 1,780 mijë lekë është arkëtuar vlera 832 mijë lekë.
–Situata e mësipërme, vazhdon të tregojë se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë "Familjar", duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018, e ndryshuar, detyrim për t'u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "Familjar". Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Vau i Dejës duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Vau i Dejës dhe NJA.
-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Vau i Dejës dhe Njësive Administrative, taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të "Njoftim Vlerësimit", apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
Bashkia Vau i Dejës nuk ka një akt marrëveshje me Ujësjellës Sh.A. Shkodër, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të rolit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar. Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr. 68/2017 *"Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"*.
Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. M. Gj, në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore; znj. M. M, znj. R. L, znj. A. Sh dhe znj. S. Gj, në cilësinë e specialistes për menaxhimin e taksave familjare.

Për vitin 2025 taksa e **fjetjes në hotel** paraqitet me realizim në vlerën 391 mijë lekë, ose 380% e planifikimit. Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është bërë planifikimi dhe realizimi i saktë i taksës së fjetjes në hotele.
Nga auditimi u konstatua se, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore këto subjekte nuk tarifohen në bazë të numrit të dhomave dhe numrit të personave të cilët akomodohen në hotele/bujtina por aplikimi i tarifës është llogaritur në bazë të vetëdeklarimeve të subjekteve. Nga Sektori i Kontrollit në Terren nuk janë kryer verifikime për të saktësuar numrin e personave që kanë fjetur dhe numrin e dhomave të rezervuara, me qëllim tarifimin e saktë të tarifës së fjetjes në hotele, veprime të cilat janë në kundërshtim me Kreun I.7, tabela 8 në paketën fiskale të vitit 2025.
Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të kësaj takse rezulton se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore ka të regjistruar 18 hotele dhe njësi akomoduese, si dhe për vitin 2025 janë arkëtuar 399,395 lekë dhe në fund të periudhës progresive deri në 31.12.2025 vlera debitore është 128,100 lekë, të cilat janë të kontabilizuara dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës, pasqyruar në kapitullin Anekse;
Për periudhën objekt auditimi specialistët e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Kontrollit dhe Borxhit Tatimor nuk kanë kryer verifikime në terren për të identifikuar dhe më pas regjistruar njësi të tjera akomoduese. Gjithashtu, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë bërë përpjekje as për të verifikuar nëpërmjet faqeve të internetit për rezervime online të hoteleve si një mënyrë për të kontrolluar nëse ka hotele apo njësi të tjera akomoduese që japin dhoma me qira dhe nuk janë të regjistruara për t'i paguar bashkisë taksën e fjetjes në hotel sipas përcaktimeve të VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore.
Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun I.7, tabela nr.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025.
-Për situatën e mësipërme (hotelet për të cilat administrohet informacion dhe kanë rezultuar me problematikë në arkëtimin e tyre si dhe hotele për të cilat nuk administrohet informacion), mbajnë përgjegjësi znj. M. Gj, Përgjegjës e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe z. Gj. D, përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Borxhit Tatimor.

Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.
Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2025, i paraqitur nga Sektori i Urbanistikës Bashkia Vau i Dejës. Nga DVASHK Shkodër, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).
Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike nuk është zbatuar pika I.3 në paketën fiskale të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2025, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe për sa i përket arkëtimit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2025, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike dhe Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, të ndjekin procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitore progresive dhe e ndarë sipas viteve, pasqyryar si më poshtë dhe në mënyrë analitike pasqyrohet në kapitullin anekse.

Tabela nr.19; Përmbledhëse për TNI, legalizimin e objekteve informale deri me 31.12.2025

Nr. lejeve	Sipërfaqja	Gjendja 31.12. 2024	Pakësuar gjatë vitit 2025	Shtuar gjatë vitit 2025	Gjendja 31.12.2025
66	**13,389**	**2,372,241**	**187,006**	**-**	**2,185,235**

Burimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Publike, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e marra u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi konkretisht:
Vlera debitore progresive për periudhën deri në fund të vitit 2025 (nga viti 2021) – vlera debitore është 2,185,235 lekë, e cila përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës. Në numër personash të cilët posedojnë lejen e legalizimit dhe që nuk kanë shlyer detyrimin e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë është 66 posedues.
Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar si rrjedhojë e mos likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, si dhe ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektorit të Urbanistikës dhe Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau i Dejës, për shkëmbimin e informacionit si dhe ndjekjen e procedurave ligjore, për arkëtimin e TNI.

Vlera debitore e kontratave për dhënien me qira të fondit pyjor, kullosor, tokë bujqësore, objekte publike që janë aktive deri në vitin 2025.
Bashkia Vau i Dejës administron 100 kontrata qiraje kryesisht për dhënie me qira fond pyjor, dhënie me qira truall dhe dhënie me qira ndërtese në njësinë qendër dhe njësitë administrative, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2008-2025 me afat qiraje 1 vjeçar deri 99 vjeçare, pasqyryar si më poshtë dhe në mënyrë analitike pasqyryar në kapitullin anekse.
Tabela nr.20;

Debitor kontrata 31.12.2024	Shtesa debitore gjatë 2025	Gjoba të vendosura gjatë vitit 2025	Pakësuar gjatë 2025	Gjendja 31.12.2025
42,070,937	40,866,451	986,240	30,623,976	53,299,652

Sipas kontratave të lidhura dhe të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të miratuara nga titullari i institucionit sipas VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" rezultoi se sipas kontratave të lidhura deri më 31.12.2024 janë debitorë 43 subjekte në vlerën 42,070,937 lekë, debitorë të krijuar për vitin 2025 janë 28 subjekte në vlerën 41,852,691 lekë dhe progresive deri 31.12.2025 janë 36 subjekte në vlerën 53,299,652 lekë, të cilat janë të kontabilizuara dhe dhe përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës.
Gjithashtu konstatohet se kontratat e qirasë së tokës bujqësore nuk janë përditësuar sipas formatit të ri të kontratës tip, miratuar me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", i ndryshuar, pasi nëpërmjet formatit të ri, ka ndryshuar masa e kamatëvonesës për mospagesën në kohë, pra nga 1% bëhet 0.5%, si dhe është parashikuar indeksimi i tarifës së qirasë 1 herë në 5 vite, periudhë e cila përkon me indeksimin që duhet t'i bëhet tarifës së qirasë në vitin 2025.
Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit "zgjidhja e kontratës" në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbarimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.
-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi znj. M. Gj, Përgjegjëse e sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Vau i Dejës.

Agjentët tatimorë

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga ASHK derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Vau i Dejës brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Vau i Dejës janë paraqitur si më poshtë.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Vau i Dejës, për vitin 2025
Tabela nr.21;

000/lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	31.12.2025
DRTSH	Tfth	149,820
DRSHTRR	Taksa e mjeteve të përdorura të transportit	22,894,588
ASHK	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	0
DR. DOGANAVE	Renta minerare	2,938

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë realizimi.

Bashkia Vau i Dejës nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se në fund të vitit 2025 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, të cilat janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, janë gjithsej 31 subjekte të gjobitura për vlerën 70,697,478 lekë, të cilat janë të kontabilizuara dhe përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Vau i Dejës, nga të cilat 4 gjoba në vlerën 2,173,989 lekë janë deri në 31.12.2024 dhe 27 subjekte të gjobitura për vlerën 68,523,489 lekë janë krijuar përgjatë vitit 2025, pasqyruar në tabelën përmbledhëse si më poshtë, dhe në kapitullin anekse në mënyrë analitike. Gjithashtu në zbatim të VKM-së nr. 274 datë 09.05.2024, janë falur 20 gjoba në vlerën 21,833,481 lekë, në praktikën e të cilave nuk administrohet një relacion mbi pasqyrimin e situatës së krijuar si dhe për vendimarrjen e Këshillit Bashkiak.

Tabela nr.22;

Gjobat deri 31.12.2024	Gjobat e vendosura gjatë vitit 2025	Pakësuar gjatë 2025	Gjendja 31.12.2025
24,007,470	68,523,489	21,833,481	70,697,478

Burimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi u konstatua se gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit është nxjerrë Urdhri i Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura.

Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit nuk është marrë asnjë masë për mbledhjen dhe arkëtimin e detyrueshëm të gjobave të vendosura, si dhe nuk janë aplikuar kamatëvonesa për subjektet e gjobitura.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 30, 31, 32 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*, nenet 164, 165, 170, 172 dhe 173 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative në RSH", neni 14 në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. M. L, Kryeinspektor i Mrojtjes Territorit.

Debitor nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se për vitin 2025, nga Policia Bashkiake është vendosur 83 gjoba në vlerën 244,800 lekë nga të cilat principal janë në vlerën

153,000 lekë dhe kamatëvonesa në vlerën 91,800 lekë të cilat janë të pa likuiduara. Pasqyryar në kapitullin anekse në mënyrë analitike.

Tabela nr.23; Gjobat e Policisë Bashkiake Vau i Dejës

Nr. gjobave	Gjobat gjatë vitit 2025	Kamatëvonesa	Gjendja 31.12.2025
83	153,000	91,800	244,800

Burimi: Sektori i Policisë Bashkiake dhe Sektori i Taksave dhe tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2025 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 244,800 lekë e cila nuk është e kontabilizuar dhe përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Vau i Dejës;
Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse[9]. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 *"Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës",* i ndryshuar.
Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*.
-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. Gj. D, Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

Përdorimi i të ardhurave.
-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2025 është realizuar përkatësisht në vlerën 169,516,732 lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime.

Tabela nr.24; Përdorimi i të ardhurave – viti 2025

Art.	Emërtimi	Të ardhurat e veta
600	Paga	
601	Sigurime Shoqërore	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	42,421,173
604	Trans. Institucioneve	2,200,851
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	4,231,390
231	Kapitale të Trupëzuara	120,663,318
	Total	**169,516,732**

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Sektori i Buxhetit dhe Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi znj. M. Gj, Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, z. Gj. D, Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Borxhit Tatimor, znj. B. F, Specialiste Nj.A. Bushat, znj. M. M, Speciaslite Taksave Familjare.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025
3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
3.2. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit.

[9] Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës", i ndryshuar, "Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmujor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

1. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme",* i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2025, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2025

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2025 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
  - Pasqyrat financiare të vitit 2025;
  - Llogaritë analitike;
  - Ditari i Bankës;
  - Ditari i Arkës;
  - Ditari i Magazinës;
  - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
  - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Shkodër;
  - Inventarët etj.

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar; si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2025 janë hartuar dhe depozituar më datën 31.03.2026 në Degën e Thesarit Shkodër.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2025 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:
  - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Vau i Dejës me NIPT K5…….O;
  - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2025-31.12.2025;
  - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
  - Përgatitur nga znj. E. T, Drejtor i Drejtorisë së Financës;
  - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr.2694, datë 31.03.2026, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës me delegim znj. A. Gj.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Shkodër të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Vau i Dejës.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.
a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.
b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vau i Dejës paraqitet si më poshtë:
Tabela nr.25; **Aktivi i Bilancit**

Llogaria	Emërtimi	2025	2024
A	**A K T I V E T**	**5,297,202,540**	**5,299,870,026**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**478,364,429**	**455,503,737**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalente të tyre	**307,456,975**	**312,422,189**
512,56	Mjete monetare në Bankë	582,250	2,231,157
520	Disponibilitete në Thesar	306,613,275	309,926,382
532	Vlera të tjera	261,450	264,650
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**17,572,775**	**15,770,939**
31	Materiale	11,142,457	9,340,621
32	Inventar i imët	6,430,318	6,430,318
	3.Llogari të Arkëtushme	**153,334,679**	**127,310,609**
468	Debitorë të ndryshëm	152,727,347	126,200,277
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	607,332	1,110,332
	4.Të tjera aktive afatshkurtra	**0**	**0**
	II.Aktivet Afat gjata	**4,818,838,111**	**4,844,366,289**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**79,479,649**	**81,491,114**
201	Primë të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
202	Studime dhe kërkime	79,479,649	81,491,114
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**4,575,862,489**	**4,686,457,172**
210	Toka, Troje, Terrene	6,208,378	6,208,378
211	Pyje, Plantacione	113,039,105	113,039,105
212	Ndërtesa e Konstruksione	1,987,703,100	2,031,633,840
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,262,266,713	2,318,219,370
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	57,913,198	65,657,026
215	Mjete Transporti	63,420,826	47,935,447
218	Inventar ekonomik	85,311,169	103,764,006
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
	4.Investime	**163,495,973**	**76,418,003**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	850,135	850,135
231	Për Aktive Afatgjata materiale	162,645,838	75,567,868

Pasqyra e pozicionit financiar (F1)
Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 5,036,387,740 lekë.

- Aktivet 5,297,202,540 lekë
- Pasivet 260,814,800 lekë
- Aktivet neto 5,036,387,740 lekë

Aktivet afatshkurtra
Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **478,364,429 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 307,456,975 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 17,572,775 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 153,334,679 lekë.

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 306,613,275 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e fondeve në thesar më 31.12.2025 në shumën 259,135,844 lekë dhe gjendja e llogarisë nr.466 "Mjete në ruajtje" e cila paraqitet në shumën

47,477,431 lekë. Gjendja e llogarisë nr.520 "Disponibilitete në thesar" rakordon me rubrikën V "Teprica në fillim të vitit ushtrimor" dhe rubrikën VI "Teprica e Likuiditeve në fund të vitit ushtrimor" lekë. *(sipas formatit F3 "Pasqyra e flukseve monetare")*

- Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve.

Tabela nr.26; Lëvizja e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar"

I.Të trashëguara nga viti 2024	**Lekë**
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
Granti i trashëguar	2,231,157
Të ardhura të trashëguara	259,557,523
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	50,368,859
Fonde specifike	264,650
FSHZH	-
Totali	**312,422,189**
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit 2025	
Granti i vitit	-
Të ardhurat e vitit	160,949,434
Të hyra nga mjetet në ruajtje	13,937,110
Granti specifik	451,862,277
FSHZH	-
Buxheti	532,029,175
Totali	1,158,777,996
Totali i të ardhurave (I+II)	**1,471,200,185**
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520 gjatë vitit 2025	
Paga sigurime (600+601)	399,833,793
Shpenzime operative (602)	116,303,270
Subvencione (603)	-
Transferime korente të brendshme (604)	9,841,636
Transferime korente me jashtë (605)	-
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	313,619,510
Kredia + Interesa për huamarje (651)	-
Investime (231)	295,790,461
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	16,828,538
Transferime korente të brendshme + transferta buxhetin e vet	9,877,095
Shpenzime me grant BE (600+601+602+231)	1,648,907
	1,163,743,210
Totali	**307,456,975**

-Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Vau i Dejës në 31.12.2025 paraqiten në vlerën 17,572,775 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 11,142,457 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Objekte inventari" në vlerën 6,430,318 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën [(- 1,801,836 lekë ndryshimi i gjendjes së inventarit) + (3,200 lekë diferenca në llogarinë nr.532 "Vlera te tjera")] = -1,798,636 lekë përbën efektin në shpenzime e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" *(pasqyra F2 – performanca financiare).*

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaritë e arkëtueshme janë në vlerën 153,334,679 lekë të përbëra nga:

-Llogaria 423-429–Personeli, defiçite, gjoba, paradhënie në vlerën prej 48,934 lekë, që përbëhet detyrime të punonjësve;

-Llogaria 468–Debitor të ndryshëm në vlerën prej 152,727,347 lekë, për taksa dhe tarifa vendore, si dhe detyrime nga të ndryshme.

-Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 607,332 lekë, e cila përfaqëson fonde nga buxheti i shtetit për pagat e gjendjes civile.

Aktivet afatgjata janë në vlerën neto prej 4,818,838,111 lekë, nga të cilat:

Aktivet afatgjata jomateriale në vlerën neto prej 79,479,649 lekë;

-Gjendja e llogarisë 202 "Studime e projektime" në çelje të vitit 2025 gjendjet në vlerën 81,491,114 lekë (Kosto historike – amortizim i akumuluar), ndërsa në fund të vitit 2025 rezulton në vlerën 79,479,649 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesa gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].

Përshkrimi	**Çelje 2025**	**Shtesa 2025**	**Pakësime 2025**	**Viti 2025**

Gjendja fillestare me 01.01.2025	81,491,114			81,491,114
Hartimi i planit të mbarështimit të pyjeve		10,212,202		10,212,202
Amortizimi			(12,223,667)	(12,223,667)
TOTALI	**81,491,114**	**10,212,202**	**(12,223,667)**	**79,479,649**

Aktivet afatgjata materiale në vlerën neto prej 4,575,862,489 lekë;
-Gjendja e llogarisë 210 "Toka, troje dhe terrene", në çelje të vitit 2025 ka qenë në shumën 6,208,378 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2025.
-Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione", në çelje të vitit 2025 ka qenë në shumën 113,039,105 lekë, e pandryshuar dhe në fund të vitit 2025.
-Gjendja e llogarisë nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione" në fund të vitit 2025 është në vlerën 1,987,703,100 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].
-Gjendja e llogarisë nr.213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në fund të vitit 2025 është në vlerën 2,262,266,713 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].
-Gjendja e llogarisë nr.214 "Instalime teknike, makineri e paisje" në fund të vitit 2025 është në vlerën 57,913,198 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].
-Gjendja e llogarisë nr.215 "Mjete transporti" në fund të vitit 2025 është në vlerën 63,420,826 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)].

Llog.	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2025	Shtesa 2025	Pakësime 2025	Gjendje në fund
210	Toka, troje, Terrene	6,208,378.00	-	-	6,208,378.00
211	Pyje, Kullota Plantacione	113,039,105.00	-	-	113,039,105.00
212	Ndërtesa e Konstruksione	2,031,633,840.00	68,327,507.00	112,258,247.00	1,987,703,100.00
213	Rrugë, rrjetë, vepra ujore	2,318,219,370.00	62,772,573.00	118,725,230.00	2,262,266,713.00
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	65,657,026.00	8,329,817.00	16,073,645.00	57,913,198.00
215	Mjete transporti	47,935,447.00	28,193,398.00	12,708,019.00	63,420,826.00
218	Inventar ekonomik	103,764,006.00	2,807,920.00	21,260,757.00	85,311,169.00
219	**Amortizimi i AAGJM (-)**			**(281,025,898.00)**	**(281,025,898.00)**
	Totali	**4,686,457,172.00**	**170,431,215.00**	**(281,025,898.00)**	**4,575,862,489.00**

Tabela nr.27; **Pasivi i Bilancit**

Llogaria	Emërtimi	2025	2024
B	**PASIVET (DETYRIMET)**	**260,814,800**	**285,465,875**
	I.Pasivet Afatshkurtra	**260,814,800**	**285,465,875**
	1. Llogari të Pagushme	**112,983,806**	**164,161,951**
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	28,100,430	76,573,931
42	Detyrime ndaj personelit	23,641,227	23,566,185
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,815,521	1,768,421
435	Sigurime Shoqërore	7,208,813	7,147,836
436	Sigurime Shëndetësore	983,034	984,032
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	2,918	11,255
44	Institucione të tjera publike	13,000	
466	Kreditore për mjete në ruajtje	47,477,431	50,368,859
467	Kreditore të ndryshëm	3,741,432	3,741,432
	2.Të tjera pasive afatshkurtra	**147,830,994**	**121,303,924**
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese	147,830,994	121,303,924
	II.Pasivet Afat Gjata	**0**	**0**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Vau i Dejës më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit Dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve.

Pasivet (Detyrimet) janë në vlerën prej 260,814,800 lekë të ndara përkatësisht, si më poshtë vijon:
-Llogaria 401-408 Furnitor dhe llogari të lidhura me to, është në vlerën prej 28,100,430 lekë të cilat janë detyrime ndaj të tretëve për faturat e mbërritura pranë financës, por të palikuiduara brenda vitit.

-Llogaria 42-Detyrime ndaj personelit, është në vlerën prej 23,641,227 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2025, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2026.
-Llogaria 431-Detyrime ndaj shtetit për tatim mbi të ardhurat nga paga në masën 15% sipas klasifikimit të pagave dhe tatimit në burim është në vlerën prej 1,815,521 lekë, që përfshin tatimin e pagave dhe tatimin në burim të muajit Dhjetor 2025, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2026.
-Llogaria 435-Sigurimet shoqërore 9.5% punëmarrësi dhe 15% punëdhënësi, si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 7,208,813 lekë.
-Llogaria 436-Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi dhe 1.7% punëdhënësi, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 983,034 lekë.
- Llogaria 437, 438 - Organizma të tjerë shtetërore dhe është në vlerën prej 983,034 lekë.
- Llogaria 44 - Institucione te tjera publike dhe është në vlerën prej 13,000 lekë.
-Llogaria 466-Kreditor për mjete në ruajtje, është në vlerën prej 47,477,431 lekë në të cilën përfshihen 5% garanci difektesh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati garancisë së punimeve të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por edhe garanci për të cilat nuk është bërë i mundur likuidimi i tyre. Llogaria 466 është debituar gjatë vitit 2025 në vlerën -16,828,538 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të kthyera ndaj palëve të treta në kredi të bankës, si dhe është kredituar për vlerën 13,937,110 lekë, që përfaqëson garancitë e mbajtura nga Bashkia Vau i Dejës kundrejt palëve të treta, në debi të bankës.
-Llogaria 4341-Operacione me shtetin detyrime është në vlerën prej 0 lekë. Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime) është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 5,036,387,740 lekë. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Tabela nr.28;

Llogaria	Emërtimi	2025	2024
	FONDI I KONSOLIDUAR:	**5,036,387,740**	**5,014,404,151**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar	4,349,190,143	4,329,990,145
12	Rezultatet e mbartura	436,914,374	303,965,225
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	4,936,960	133,453,611
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme	245,346,263	246,995,170

-Llogaria 101-Teprica (Fondi Akumuluar), është në vlerën prej 4,349,190,143 lekë, e përberë nga aktivet materiale dhe jomateriale, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materialet dhe objekte inventari).
-Llogaria 85-Rezultati veprimtarisë ushtrimore, është në vlerën prej 4,936,960 lekë (Të ardhurat – Shpenzimet), e përbërë nga fondet buxhetore, që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.
-Llogaria 105-Grante kapitale të brendshme, është në vlerën prej 245,346,263 lekë.

Pasqyra e Performancës Financiare

Tabela nr.29; **Të ardhurat**

Llogaria	Emërtimi	2025	2024
A	**TË ARDHURAT**	**1,136,617,360**	**1,090,301,828**
70	**I.TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET**	68,304,327	63,307,990
700	**1.Tatimi mbi të Ardhurat**	**149,820**	**179,478**
7002	Tatim mbi Biznesin e vogël	149,820	179,478
702	**2.Tatimi mbi Pasurinë**	**20,474,169**	**21,028,117**
7020	Tatim mbi Pasurinë e palujtshme	20,474,169	21,028,117
703	**3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**47,658,128**	**42,075,490**
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	22,894,588	20,222,950
7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	24,763,540	21,852,540
708	**6.Të tjera Tatime e Taksa Kombëtare**	**22,210**	**24,905**
71	**III.TË ARDHURA JO TATIMORE**	**68,671,405**	**47,240,898**
710	**1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**35,740,504**	**14,657,004**
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	35,740,504	14,657,004
711	**2.Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**32,930,901**	**32,583,894**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	29,389,443	29,951,508

7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	418,718	491,769
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	322,000	241,692
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	2,800,740	1,898,925
72	**V.GRANTE KORENTE**	**999,641,628**	**979,752,940**
720	**1.Grant korent i Brendshëm**	**999,641,628**	**979,752,940**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	441,408,810	425,978,534
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	544,029,177	519,580,947
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	11,947,402	14,444,953
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	607,332	605,870
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretë)	-	616,000
721	**2.Grant korent i Huaj**	**1,648,907**	**18,526,636**
7211	Nga Organizata Ndërkombëtare	1,648,907	18,526,636

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Të ardhurat tatimore

Llogaria 70 në vlerën prej 68,304,327 lekë, nga të cilat:
Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 149,820 lekë.
Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 20,474,169 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore, ndërtesës, truallit.
Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 47,658,128 lekë.
Llogaria 708-Të tjera Tatime e Taksa kombëtare, në vlerën prej 22,210 lekë.

Të ardhurat jo tatimore

Llogaria 71 në vlerën prej 68,671,405 lekë e përbërë nga:
Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia, në vlerën prej 35,740,504 lekë.
Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare, në vlerën prej 32,930,901 lekë.

Grante

Llogaria 72-Grant Korent i brendshëm, në vlerën prej 999,641,628 lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, grant i huaj.

Tabela nr.30; **Shpenzimet**

Llogaria	Emërtimi	2025	2024
B	**SHPENZIMET**	**1,131,680,400**	**956,848,217**
600	**I.Pagat dhe përfitimet e punonjësve**	**343,298,769**	**314,608,882**
6001	Paga, personel i përhershëm	343,298,769	314,344,882
6002	Paga personel i përkohshëm	-	264,000
601	**II.Kontribute të sigurimeve**	**57,279,675**	**52,446,777**
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	51,441,894	47,101,079
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	5,837,781	5,345,698
602	**III.Blerje mallra e shërbime**	**116,189,881**	**103,227,895**
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	6,894,281	8,661,342
6021	Materiale dhe shërbime speciale	6,942,766	8,500,753
6022	Shërbime nga të tretë	51,196,957	41,224,104
6023	Shpenzime transporti	27,146,949	27,373,855
6024	Shpenzime udhëtimi	130,120	98,640
6025	Shpenzime peër mirëmbajtje të zakonshme	5,134,560	3,306,000
6026	Shpenzime për qiramarrje	2,420,678	1,930,882
6029	Shpenzime të tjera operative	16,323,570	12,132,319
	V.Transferime korente	**323,461,146**	**340,161,707**
604	**1.Transferime korente të brendshme**	**9,841,636**	**22,704,177**
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	9,241,636	21,014,172
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	600,000	600,000
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	-	1,090,005
606	**3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë**	**313,619,510**	**317,457,530**
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	313,619,510	317,457,530
	VII.Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara	**293,249,565**	-
681	Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit	293,249,565	
682	Vlera e mbetur e AAGJ, të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura		
683	Shuma të parashikuara të shfrytëzimit		
686	Shuma të parashikuara për aktivet financiare		
63	**VIII.Ndryshimi i gjendjes së inventarit**	- 1,798,636	1,309,553
	IX.Shpenzime të tjera	-	***145,093,403***
85	**Rezultati i Veprimtarisë së vitit ushtrimor**	**4,936,960**	**133,453,611**

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi se:

1. Llogaria nr.26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vetë" në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerën 0 lekë, e njëjtë edhe në fund të vitit 2025. Nga verifikimi i kryer në databazën e QKB-së, rezultoi

se Bashkia Vau i Dejës zotëron aksione në disa Shoqëri Aksionare. Konkretisht Bashkia Vau i Dejës, zotëron aksione në:
-Shoqëria Rajonale U. K. Sh, NIPT M3…….O, me pjesëmarrje 3.230 %, 12,493.64 aksione me vlerë nominale të aksionit 1.000 lekë, pra 1,249,364,000 lekë;
-Z. A, NIPT M2…….I, me pjesëmarrje 100 %, 1 kuotë me vlerë 100 lekë, pra 100 lekë;
-Ndërkomunale Bushat, NIPT K8…….A, me pjesëmarrje 100 %, 24,160 aksione me vlerë nominale të aksionit 100,000 lekë, pra 24,160,000 lekë;
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet në UMF nr.8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar ku citohet në seksionin 3.1, paragrafi 31 "Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për njësinë publike qendrore ose vendore që përfshin të gjitha njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi"; Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".
Llogaria nr. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vetë", është nënvlerësuar me 1,273,524,100 lekë.

2. Llogaria nr. 468 "Debitorë të ndryshëm", në fillim të vitit 2025 është në vlerën 126,200,277 lekë dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 152,727,347 lekë, pra me një rritje në vlerën 26,527,070 lekë.

Lëvizja e llogarisë 468 Sintetike				**Viti 2025**		
Viti	Bashkia Vau i Dejës dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2024	Debi	Kredi	Mbetja
2025		Debitorë të ndryshëm	126,200,277	153,906,073	127,379,003	152,727,347

Nga verifikimi i listës analitike të debitorëve në fund të vitit 2025, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën 226,389,688 lekë në total, nga të cilat:
- Vlera prej 217,088,953 lekë për taksat dhe tarifat ndaj kategorisë familjar;
- Vlera prej 9,300,735 lekë detyrime të tjera.
Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë" (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, shkronja "ë", pika 3, neni 12; Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja "c".
Llogaria nr.468 "Debitorë të ndryshëm", është nënvlerësuar me 226,389,688 lekë.

3. Llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Vau i Dejës, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 47,477,431 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Lëvizja e llogarise 466 Sintetike				**Viti 2025**		
Viti	Bashkia Vau i Dejës dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2024	Debi	Kredi	Mbetja
2025		Garanci	50,368,859	16,828,538	13,937,110	47,477,431

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2025, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Vlera e garancive të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes është 40,587,301 lekë.
-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 40,587,301 lekë për vitin 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4". Ndikim negativ në

vendimmarrjen e nivelit drejtues të Bashkisë Vau i Dejës për kryerjen e përmirësimeve në veprimet kontabël gjatë vitit ushtrimor 2025.

4. Llogaria nr.42 "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Vau i Dejës, në fund të vitit 2025 është në vlerën prej 23,641,227 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2025, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2026. Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa" mbi të ardhurat nga paga në masën 15% sipas klasifikimit të pagave dhe tatimit në burim është në vlerën prej 1,815,521 lekë, që përfshin tatimin e pagave dhe tatimin në burim të muajit dhjetor 2025, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2026. Llogaria 435-Sigurimet shoqërore 9.5% punëmarrësi dhe 15% punëdhënësi, si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 7,208,813 lekë. Llogaria 436-Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi dhe 1.7% punëdhënësi, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 983,034 lekë.

Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve të muajit janar të vitit 2026 lidhur me likuidimin e detyrimeve të mësipërme, janë konstatuar diferenca në kontabilizim, si dhe mungesë të kontabilizimit, konkretisht:

Llogaria	Sipas PF	Sipas U.Sh	Diferenca	Koment
42	23,641,227	23,851,731	210,504	Pasqyruar më pak në PF
431	1,815,521	1,980,126	164,605	
435	7,208,813	7,338,816	130,003	
436	983,034	1,003,043	20,009	
Total			**525,121**	

Mungesë e kontabilizimit në llogaritë 42

Përshkrimi	Vlera neto (zbritur TAP)
Shpërblim Këshilltarët	960,347
Pagesë Leonard Dodani	39,474
Total	**999,821**

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, shkronja "ë", pika 3, neni 12; Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, rubrika 3.3 "Detyrimet Afatgjata". Pra sa më sipër llogaritë 42; 431, 435 dhe 436 janë nënvlerësuar për vlerën 1,524,942 lekë.

5. Llogaria nr.467 "Kreditor të tjerë" në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerën 3,741,432 lekë e pa ndryshuar edhe në fund të vitit 2025. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se në llogarinë nr.467 nuk janë kontabilizuar të gjitha detyrimet e krijuara në vlerën 298,313 lekë, pasqyruar në tabelën më poshtë.

Mungesë e kontabilizimit

Nr.	Emër Mbiemër	Për likuidim 2026
1	Qira Objekti	85,000
2	Subvencion Qira	119,813
3	Pagesë eksperti	93,500

Këto veprime janë në kundërshtim me Funksionimin kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

Llogaria nr. 467 "Kreditor të tjerë", nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2025.

6. Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogaria nr.681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit" në fund të vitit 2024 është në vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 293,249,565 lekë.

Sa më sipër konstatohet se është njohur si shpenzim në pasqyrën e performancës financiare, vlera e amortizimit të përllogaritur për aktivet e trupëzuara dhe jo të trupëzuara të Bashkisë Vau i Dejës, ndërkohë kjo llogari përdoret për amortizimin e AAGJ-së (në analizat përkatëse), si element kostoje, në institucionet, që krahas aktivitetit buxhetor realizojnë edhe aktivitet tregtar apo prodhimi, si dhe në amortizimin e subvencioneve për investime. Pra nuk mund të njihet si shpenzim, amortizimi i përllogaritur për një shkollë, rrugë, qendre shëndetësore, në momentin që në këto objekte nuk realizohet aktivitet tregtar për llogari të Bashkisë Vau i Dejës.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, pika 4 "Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8)". Efekti: Llogaritë e shpenzimeve nuk janë kontabilizuar saktë, duke ndikuar në rezultatin e veprimtarisë së vitit ushtrimor.

7. Gjendja e llogarisë nr.4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën kontabël 607,332 lekë. Llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:
Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: Debitohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)"; Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti". Nga analiza e llogarisë analitike, rezulton se në llogarinë 4342, është kontabilizuar vetëm vlera 607,332 lekë, që përfaqëson detyrimin për pagat ndaj punonjësve të Gjendjes Civile.
-Sa më sipër konstatohet se në llogarinë 4342 nuk janë kontabilizuar detyrimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatimi nga të ardhurat nga punësimi, tatimi në burim, fatura me objekt "Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme". Vlera që duhej të kontabilizohej është 35,265,763 lekë.
-Sa më sipër llogaria nr.4342 është nënvlerësuar me vlerën 35,265,763 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, klasa 4 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të tretëve".
Llogaria nr. 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2025.

8. Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.210 "Toka, troje, terrene" dhe llogarisë nr.211 "Pyje Plantacione".
Gjendja e llogarisë nr.210 "Toka, Troje, Terrene" në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 6,208,378 lekë, e pa ndryshuar është dhe në fund të vitit 2025.
Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit në vijim:

Analiza e llogaria 210-Toka, troje e terrene

Nr.	Përshkrimi i aktivit	Vlera
1	Bashkia Vau i Dejës	3,890,878
2	Terrene për shkollën Fshat i ri (viti 20015)	770,000
3	Terrene për shkollën + Qend.Shënd. Konaj (viti 2005)	770,000
4	Tokë arë për varreza publike Mali Jushit (viti 2012)	777,500
Totali		**6,208,378**

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:
Në llogarinë 210 "*Toka, Troje, Terrene*", nuk janë kontabilizuar:
a) vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë nr.212 "Ndërtime e konstruksione";
b) vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të ish Komunave, aktualisht Njësi Administrive të Bashkisë Vau i Dejës, si VKM nr.566, datë 22.08.2012[10]; VKM nr.768, datë

[10] Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hajmel të Qarkut të Shkodrës;

24.09.2010[11]; VKM nr.68, datë 28.1.2008[12]; VKM nr.1423, datë 10.10.2008[13]; VKM nr.696, datë 19.10.2007[14] etj.

-Gjendja e llogarisë nr.211 "Pyje, kullota, plantacione" në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 113,039,105 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2025.
Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera për pyllëzime në zona të ndryshme, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkimi i aktivit	Vlera
1	Sistemim dhe gjelbërim Qendra e Komunës	1,141,840
2	Mbjellje Fidan pyjor	1,074,377
3	Përmirësim pyjor	398,000
4	Pyllëzim fshati Toplan	331,495
5	Pyllëzim fshati Koman	475,158
6	Pyllëzim fshati Kishë	270,037
7	Gjelbërim mjediseve publike Bashkisë Vau i Dejës	87,096,000
8	Përmirësim dhe fuqizim i Parkut të Landfillit	8,457,927
Totali		**13,794,271**

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:
Në llogarinë nr. 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk janë kontabilizuar:
a) vlerat e pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM të veçanta kanë kaluar në pronësi të ish Komunave, aktualisht NJA Bashkia Vau i Dejës, si VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", e ndryshuar; VKM nr. 409, datë 8.4.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Vau i Dejës të Qarkut të Shkodrës".
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap III, pika 30, i ndryshuar.
Llogaritë nr. 210 "Toka, troje, terrene" dhe nr. 211 "Pyje Plantacione", nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025.

9. Llogaria nr. 203 "Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme" në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerën 0 lekë e pa ndryshuar edhe në fund të vitit 2025. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion (ditarit të bankës) rezultoi se Bashkia Vau i Dejës, Sektori i Taksave dhe Sektori i Financës, kanë në përdorim dy programe kompjuterike për aktivitetin e tyre, konkretisht programin "Alpha Cloud" për kontabilitetin dhe programin "SiZ1N" për taksat dhe tarifat vendore.
Sa më sipër konstatohet se në llogarinë e AAGJ/JM nuk është bërë kontabilizimi i vlerës 2,109,847 lekë, kosto e blerjes së dy programeve kompjuterike.
Këto veprime janë në kundërshtim me Funksionimin kontabël i llogarive të klasës 2, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.
Llogaria nr. 203 "Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme", nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2025.

10. Gjendja e llogarisë nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione" në fund të vitit 2025 është në vlerën 198,7703,100 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2025 + shtesat gjatë vitit) –

[11] Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Hajmel të Qarkut të Shkodrës;
[12] Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës;
[13] Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Vau i Dejës të Qarkut të Shkodrës;
[14] Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Vau i Dejës të Qarkut të Shkodrës;

(amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2024 + amortizimin e vitit 2025)]. Nga verifikimi i llogarive, konstatohet se në AQT nuk janë kontabilizuar vlerat e punimeve të riparimit në aktive të ndryshme dhe blerjeve të aktiveve, të kryera përgjatë vitit 2025. Gjithsej vlera e pakontabilizuar është 1,451,880 lekë.

Emërtimi	Vlera
Shërbim mirëmbajtje Ura Pasarel	384,000
F.V të 4 kioskave turistike	1,067,880
Total	**1,451,880**

Këto veprime janë në kundërshtim me Klasa 2 "Aktivet afatgjata" – "Vlerësimi i mëpasshëm" në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.
Llogaria nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione", nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025.

11. Rezulton se për vitin 2025 Bashkia Vau i Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit, si rrjedhojë llogaritë analitikë janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, neni 2, neni 4, pika 9 *"Përgjegjshmëria menaxheriale"*; Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar, pika 5 pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.
Për sa më sipër, mbanë përgjegjësi, Znj. E. T, Hartuese e Pasqyrave Financiare për vitin 2025.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

III.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.
4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit*", Kontrollit i Lartë i Shtetit me shkresën me nr.36/13 prot., datë 14.10.2025, ka dërguar në Bashkinë Vau i Dejës, "Raportin Përfundimtar" me masat përkatëse për përmirësimin e gjendjes.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:
Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "j", Bashkia Vau i Dejës duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Vau i Dejës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr.36/13 prot., datë 14.10.2025 **ka kthyer përgjigje** me shkresën nr. 36/14 prot., datë 24.10.2025 në KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:
Referuar shkresës nr.36/13 prot., datë 14.10.2025, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2, "*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit*

të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna". Sipas verifikimit Bashkia Vau i Dejës **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH.
-Bashkia Vau i Dejës nuk ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, dhe si rrjedhim **nuk ka raportuar** rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 50, pika 5.

III. Rekomandimet e KLSH-së:
Auditimi i fundit në Bashkinë Vau i Dejës është kryer në vitin 2025 për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr.36/13 prot., datë 14.10.2025. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:
- 23 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 1 masë e ardhur e munguar në vlerën 352,589,965 lekë;
- 1 masë për eleminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën 226,389,688 lekë, pranuar nga subjekti;
- 3 masa disiplinore
-1 masë njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil.
Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës dhe Këshilli Bashkiak, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit të përgjithshëm strategjik të zhvillimit. Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, regjistrin e riskut, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin e risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit si dhe gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që pranimi i punonjësve të realizohet përmes një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë, bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit, me qëllim rekrutimin efektiv të burimeve njerëzore. Gjithashtu të marrë masa për plotësimin, sistemimin dhe administrimin me të dhënat e nevojshme dosjet e personelit për çdo të punësuar si dhe hatimin e një programi trajnimesh për punonjësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi 2.1. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit

3.1 Rekomandimi Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që strukturat e audituara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, të hartojnë plan veprimet për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që materialet e hartuara nga njësia të kenë një pasqyrë të plotë të situatës e të jenë

mbështetje për titullarin në arritjen e objektivave. Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që të realizojë angazhimet e planifikuara si dhe të përfshijë në planin vjetor të auditimit zbatimin e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e situatës në subjektin e audituar.

Menjëherë në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se eshte ngritur Urdheri me nr.741 date 04.11.2025 nga Titullari mbi marrjen e masave nga ana e NJAB per zbatimin e rekomandimit, pika 3.1 B. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.*
Rekomandimi është zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë kontabilizimin e llogarisë 604 *"Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverise"* të llogarisë 606 *"Transferta për buxhet familjarë e individët"* dhe llogarisë 231 *"Investime në proces"*, për të siguruar përputhjen midis vlerave të rakorduara me thesarin dhe vlerave të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar dhe te performances financiare. Gjithashtu të sigurojë që kontabilizimi në llogaritë e aktiveve AAGJM-ve të kryhet në momentin e kapitalizimit të investimeve dhe jo në vlera pjesore të cilat i përkasin llogarisë 230 - 231 *"Investime në proces"*.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* për vlerën 126,103,912 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 63 *"Ndryshimi gjendjes së inventarit"* për vlerën 156,101 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar gjendjen e llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* për vlerën prej 112,682,760 lekë.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar gjendjen e llogarisë 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* për detyrimet që rezultojnë të shtuara për vitin 2024 në vlerën prej 68,629,996 lekë dhe llogarinë 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"* për detyrimet e viteve të mëparshme për vlerën 57,570,281 lekë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar amortizimin për llogarinë 202 *"Studime e projektime"*, llogarinë 212 *"Ndërtime e konstruksione",* llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"*, llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje",* llogarinë 215 *"Mjete Transporti"* dhe llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"*.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Aseteve ne bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit te marrin masa për regjistrimin e aseteve te Bashkisë dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet gjendjen sipas llogarive analitike për llogarinë 202 *"Studime e projektime"*, llogarinë 212 *"Ndërtime e konstruksione",* llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"*, llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje",* llogarinë 215 *"Mjete Transporti"* dhe llogarinë 218 *"Inventar ekonomik"*.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi 11.1. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit.

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për vlerën

prej 74,319,968 lekë midis të dhënave të thesarit dhe të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar për llogarinë 23 *"Investimet"*.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve të bashkisë konform legjislacionit në fuqi.

Në fund të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar:
- Pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar "Shoqëria Rajonale U. K. Shkodër Sha" me NIPT M3…….O për vlerën prej 1,1294,364 lekë.
- Pjesëmarrjen në kapital në Z. A, me NIPT M2…….I në vlerën 100 lekë.
- Pjesëmarrjen në shoqërinë Ndër komunalë Bushat K87108002A në vlerën 24,160,100 lekë.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi 14.1. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të identifikojë objektet që i përkasin Ujësjellësve dhe të kryejë procedurat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale U. K, Shkodër Sh. A" me NIPT M3…….O.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të hartojë pasqyrat financiare të konsoliduara, duke përfshirë kompanitë të cilat kontrollohen në kapitalin e tyre nga njësia Bashkia Vau i Dejës.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 4864 *"Detyrimet e prapambetura"* për mospërputhjen e saj në vlerën 5,443,875 lekë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

17.2 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa për respektimin radhën e kryerjes së pagesave konform legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi 17.2. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit..

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 466 *"Kreditor për mjete në ruajtje*", të sigurojë listën analitike të sajë e cila rezulton në fund të vitit 2024 në vlerën prej 50,368,859 lekë për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende.

Menjëherë e në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi 18.1. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit.

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 475 "*Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse"* për vlerën 121,303,924 lekë dhe të sigurojë paraqitjen e saj të saktë në llogarinë 470 *"Llogari në pritje-të ardhura për tu marrë".*

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

20.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar"* e cila është nënvlerësuar për vlerën 234,356,333 lekë në fund të vitit 2024.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë *"Shpenzime të tjera"*, e cila është e paraqitur në mënyrë të pasaktë për vlerën prej 145,093,403 lekë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

22.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes, **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi si vijon.
- Masat të dërguara me shkresën e KLSH me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025.
Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

- Masat të dërguara me shkresën e KLSH me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025.
Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:
A. MASA ORGANIZATIVE
1.1.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për disponimin e planit të masave dhe veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së PBA dhe Projektbuxhetit Vjetor, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës si dhe mbajtjen e mbledhjeve të dokumentuara të GMS për diskutimin rreth planifikimit, monitorimit politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve tjera menaxhimit financiar.*
2.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pagesën e detyrimeve të prapambetura për vlerën 70,236,317 lekë, në 19 raste sipas evidencave analitike që shoqërojnë raportimin periodik në MFE, brenda afatit të parashikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm, sipas llojit të detyrimeve, konkretisht:*
- Fatura të prapambetura për investime për vlerën 62,711,937 lekë, e ndarë:
- Vendime gjyqësore të pa likuiduara për vlerën 3,342,860 lekë.
Gjithashtu të kërkojë në Ministrinë e linjës miratimin e fondeve, për të mundësuar shlyerjen e faturave të prapambetura për investimet e pa likuiduara.
3.1. Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për caktimin e super vizorit të pastrimit, për mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe njësive administrative, mbajtjen të të gjithë dokumentacionit të mbikëqyrjes së kërkuar si dhe mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa pastrimit, që mblidhet për këtë qëllim.*
Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për reduktimin e shpenzimeve të karburantit dhe mbajtjen e një dokumentacioni të argumentuar për harxhimin e tij, duke, plotësuar fletudhëtimet me gjithë të dhënat që kërkohen; plotësuar akt-rakordimet, sipas kilometrave të përshkuara; vlerësimin e gjendjes teknike të disa automjeteve nëse janë rentabël ose jo dhe vendosjes së një raporti të drejtë midis numrit 23 të automjeteve me nevojën, ngarkesën dhe shfrytëzimin e tyre.
4.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për realizimin e një planifikimi të studiuar dhe të argumentuar me dokumente dhe të dhëna të sakta për taksat dhe tarifat vendore, raportimin veçmas të vlerës të paguar për vitin ushtrimor dhe veçmas për vlerën e detyrimeve prapambetura te paguara taksave vendore, nëpërmjet përfshirjes në një kolonë të veçantë në sistemin elektronik të detyrimeve të prapambetura të taksave vendore.*
5.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve të tokës tepër nga legalizimi ose AMTP kaluar "shtet", për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim si dhe për sipërfaqet e tokës tepër kaluar shtet, si rezultat i diferencave midis AMTP dhe librit të ngastrës sipas sipërfaqes faktike në terren, duke bashkëpunuar me ASHK Shkodër.*
6.1. Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për kompletimin e dosjeve të bizneseve me dokumentacionin e kërkuar, të rishikoje ngarkesat fiskale, të llogarisë taksën e ndërtesës për 1 rast të shmangur si dhe të inventarizojë dosjet e subjekteve.*
7.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për hartimin dhe dërgimin e raporteve periodike mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, pyetësorit të*

vetëvlerësimit dhe deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, të merren masa për menaxhimin e riskut duke përfshirë politikat të ruajtjes së burimeve njerëzore me qëllim minimizimin e lëvizjeve të punonjësve, hartimin e regjistrit të riskut, strategjisë së riskut dhe ngritjes së Grupit të Menaxhimit Strategjik për arritjen e objektivave institucionalë.

10.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për regjistrimin e plotë dhe të saktë në sistemin e kontabilitetit të të gjitha aseteve të transferuara me akte ligjore dhe nënligjore duke përfshirë sipërfaqen e transferuar me çmimin përkatës të referencës. Të kryhet procesi i regjistrimit analitik në kartela të veçanta i të gjithë aseteve të cilat paraqiten pa informacion historik në regjistrin e aseteve duke shfrytëzuar të dhënat e thesarit ndër vite dhe në të njëjtën kohë të llogaritet amortizimi për këto asete.*

12.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për mbajtjen e regjistrimeve në sistemin e kontabilitetit në nivel artikulli në kartelat e llogarisë për aktivet afatshkurtra dhe furnizimet e daljet e tyre të kryhen sipas furnizimit të kryer dhe jo mbi baza mujore. Për vitin financiar 2023 të merren masa për rakordimin e llogarisë së ndryshimeve në inventar sipas diferencës së llogarive në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar dhe në të njëjtën kohë të merren masa për pasqyrimin e saktë për vitin 2023 të furnizimeve në llogaritë "Materiale speciale" në vlerën 1,425,000 lekë dhe "Materiale dhe pajisje laboratorik e te shërbimit publik" në shumën 257,520 lekë.*

15.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të paraqiten saktë në pasqyrat financiare të gjitha të ardhurat e vitit të konstatuara sipas përllogaritjeve me detyrimet vjetore nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe jo mbi bazë të arkëtimeve.*

16.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për shlyerjen e detyrimeve për mallra e shërbime brenda vitit buxhetor në të cilin paraqitet fatura e furnitorit për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara. Të kryhen veprimet rregulluese për rastet e parapagimeve dhe të njihet shpenzimi pasi të jetë vërtetuar sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Për rastet e transfertave drejt njësive të tjera në llogarinë 604 dhe 603 dokumentacioni shoqërues i praktikës të shoqërohet me vendimmarrje për llojin e transfertës në formën e grantit, borxhit apo rritjes së kapitalit në mënyrë që të gjykohet për klasifikimin e drejtë të artikullit kontabël dhe konsistent për transaksione të ngjashme.*

17.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të pajisin me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit në ASHK – Shkodër.*

18.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kullosor dhe të ndjekë procedurat ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.*

19.1.Rekomandimi: *Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të ndërmarrë të gjitha masat dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtim e 16 gjobave të vendosura nga IMT.*

20.1. Rekomandimi: *Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim edhe me Kryetarin e Bashkisë, të marrë të gjitha masat administrative për aplikimin e gjobave për ndërtimet pa leje dhe shkeljes së lejes së ndërtimit të konstatuara ndaj kundërvajtësve si dhe ekzekutimin e vendimeve për prishje.*

21.1. Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës në të gjitha rastet e dhënies me qira të aseteve të ndjekë procedurat ligjore, të pajisë me certifikatë pronësie asetet dhe të përcaktojë saktë llojin e asetit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.*

22.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të ndërmarrë masat për subjektin A. T, ShPK. dhe A –B 07, të zbatojë procedurat sipas ligjit për ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor.*

23.1. Rekomandimi: *Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vau i Dejës, rast pas rasti të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit*
të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eleminimin e praktikave të tilla, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike të çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

24.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa që në hartimin e regjistrave të parashikimit të prokurimit publik sipas kërkesave të njësive respektive të prokurohen me procedura të*

hapura nevojat për mallra dhe shërbime të ngjashme/njëjta me qëllim shmangien e procedurës së blerjeve të vogla.

25.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të dokumentohet përllogaritja e fondit limit dhe të gjitha dokumentacionet e tjera që provojnë normativat dhe kilometrat/orët e punës për përllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit që përfshijnë blerje karburanti si dhe KVO të përfshijë specialistë të fushës.*

- Masa organizative të dërguara me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024.

Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

1.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kërkesat e "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin".*

1.2.Rekomandimi: *Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim te Titullari nga secila drejtori/sektor, etj., si dhe të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.*

4.1. Rekomandimi: *Bashkia Vau Dejës të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.*

7.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.*

14.1. Rekomandimi: *Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 21 pronave të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës.*

15.1. Rekomandimi: *Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.*

Masat e rubrikës "Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara", nga KLSH ri kërkohen për zbatim, si vijon:

1.1. Rekomandimi: *Titullari i Bashkisë Vau Dejës të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të planifikojë të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 2,847,329 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e lartpërmendura të Bashkisë Vau Dejës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.*

2.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:*

1. *Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 197,839 mijë lekë;*
2. *468 Biznese Debitorë në vlerë 33,447 mijë lekë.*

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
4.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën dhe me pas sipas procedurave të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Vau Dejës me vlerë 3,116,667 lekë për vitin 2022 dhe vlera 15,800,000 lekë për autorizimet vlera progresive. Gjithashtu, Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.*
5.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqërinë "S.P.E. Gjadër ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.*
6.1. Rekomandimi: *Drejtoria e shërbimit Pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.*
Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

- Masat të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023.
Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:
- Për masat e rubrikës "Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (të ardhura të munguara)", nga KLSH ri kërkohen për zbatim si vijon:
2.1.Rekomandimi: *Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej* ***19,300,000 lekë*** *sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.*

C. MASA SHPËRBLIM DËMI
1.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej* ***1,705,953 lekë pa TVSh*** *nga OE "A. I. G. C" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4747/8 prot., datë 16.11.2022, me objekt "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera. Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e defekteve në objektin e prokurimit "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi (2022)", me qëllim riparimin e tyre, para përfundimit të periudhës së garancisë.*
2.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej* ***2,431,375 lekë pa TVSh*** *nga OE "K" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4931/8 prot., datë 30.11.2022, me objekt "Ndërtim pike grumbullimi për produktet bujqësore", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.*
3.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej* ***305,922 lekë pa TVSh*** *nga OE "V. E"ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4806/9 prot datë 24.11.2022, me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.*
4.1. Rekomandimi: *Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej* ***2,752,040.7 lekë pa TVSh*** *nga BOE "L. C" ShPK. & "A. I. G. C" d.sh.h & "2T" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4885/10 prot., datë 18.10.2023, me objekt "Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e lidhjes së kontratës jo me vlerën reale të ofertuar.*
5.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të përcaktohen përgjegjësitë dhe të merren masa për të arkëtuar shumën prej 404,578 lekë për rastin e tërheqjes nga oferta të operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi.*

6.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,528,196 lekë për TVSh të përfituar tepër, në 2 raste për "pajisjet elektrike, ndriçimit rrugor", konkretisht:*
- vlerën 678,156 lekë nga subjekti "G. H, PF",
- vlerën 850,040 lekë nga subjekti "L. C" ShPK.

D. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përllogaritjes së fondit limit në total në shumën 993,670 lekë në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës.*

2.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të sipërcituara dhe të marrë masa për eleminimin e praktikave të tilla, të cilat kanë shkaktuar përdorimin pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 13,052,857 lekë.*

3.1. Rekomandimi: *Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për prokurimin e nevojave brenda buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe në përputhje me kohëzgjatjen e planifikuar të kryerjes së investimeve në rastin e punëve publike.*

E. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës:*

a. *Të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative me qëllim arkëtimin e vlerës 287,305,828 lekë, të debitorëve të taksave e tarifave vendore deri më 31.12.2023.*

b. *Sektori i taksave vendore te arkëtojë menjëherë vlerën 586,161 lekë ndaj 151 punonjësve të administratës, të cilët nuk kanë paguar taksat e tarifat vendore, nëpërmjet borderove të pagesave tyre.*

c. *Kontrolli i borxhit të bllokojë aktivitetin në vend, për subjektet biznes i madh që nuk kanë shlyer detyrimet (debitorë) e taksave vendore në vlera të larta dhe të mbartura në vite dhe që ushtrojnë aktivitet, deri në arkëtimin e tyre.*

2.1.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 2,742,872 lekë, detyrime të pa likuiduara kontraktore nga qiratë e tokës, ndërtesës dhe pyje e kullotave deri më 31.12.2023, në 23 raste.*

2.2.Rekomandimi: *Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 5,400,000 lekë, detyrime të pa likuiduara për tarifat për licenca të tregtimit të hidrokarbureve, për vitin 2022 – 2023, nga 14 subjekte.*

F. MASA DISIPLINORE.

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

a. ***"Vërejtje" deri në "Largim nga shërbimi civil"****, sipas shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit, për punonjësit si më poshtë:*

1. Z. E. S, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
2. Z. E. M, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
3. Znj. D. D, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
4. Znj. M. M, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
5. Znj. M. M, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
6. Znj. R. Gj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
7. Znj. S. V, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
8. Z. M. Gj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
9. Z. A. M, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
10. Zj. D. L, në cilësinë e anëtarit te Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimi dhe personit përgjegjës për prokurimet.
11.Znj. K. Sh, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimit;
12.Znj. E. Z, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe specialiste e fushës në dy raste;
13. Znj. K. C, anëtar i NJP dhe specialist i fushës në një rast;
14. Z. A, F, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
15. Znj. E. T, në rolin e nëpunësit zbatues për periudhën objekt auditimi
16. Z. N. B me detyrë Përgjegjës i Sektorit te Aseteve.
17. Znj. A. Sh, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit

18. Z. M. L, me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së
19. Z. V. Sh, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit
20. Z. E. P, me detyrë Përgjegjës i sektorit te inspektimit te Pyjeve dhe Kullotave.
21. Znj. Gj. N, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore,
22. Z. G. Rr, me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore,
23. Znj. R. L, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore,
24. Znj. L. N, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore,
25. Znj. S. Gj, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore.
26. Z. A. G, me detyrë specialist i bujqësisë
27. Znj. A. V, me detyrë specialiste e bujqësisë
28. Znj. M. Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore
29. Z. Z. P, me detyrë Përgjegjës i sektorit të bujqësisë i bashkisë.
30. Z. S. L, me detyrë Përgjegjësi i shërbimeve të administratës së bashkisë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksat dhe tarifat vendore të cilat rezultojnë në fund të vitit 2024 në vlerën prej 352,589,965 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi është i pazbatuar.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ne bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa të kontabilizojne në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* vlerën e pa kontabilizuar prej 226,389,688 lekë në pasqyrat e pozicionit financiar.

Brenda datës 31.03.2026

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi 1.1. Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit.

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në*

komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës**, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -"<u>Vërejtje" neni 58 shkronja (a), për 3 punonjës, si më poshtë</u>:

1. Znj. E. T, me detyre Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues, për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.
2. Znj.M. Gj, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore për mangësi ne administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe dërgimin për kontabilizim në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 5*/a*, me Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", Kreu II, neni 16, me paketën fiskale dhe me rregulloren e bashkisë.
3. Z. Gj. D, me detyrë Agjent i Mbledhjes së Borxhit; për mangësi ne administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, neni 5*/a*, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, neni 89,90,91,93 në kundërshtim me Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar pika 89, 90,91,93, me paketën fiskale dhe me rregulloren e bashkisë.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 *"Për Nëpunësin Civil"*, të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 *"Për Nëpunësin Civil"*, të ndryshuar.

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*
Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Vau i Dejës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*
Rekomandimi Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijojnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tek çështja përkatëse, sipas programit të auditimit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Bashkia Vau i Dejës është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4722/11 prot., datë 27.08.2026, i administruar në KLSH me shkresën nr. 734/3 prot., datë 02.09.2026, ku janë shprehur objeksionet e mëposhtme;
<u>Pretendimi i Subjektit:</u> *Në lidhje me rekomandimet e lëna nga grupet e mëparshme, sqarojme se rekomandimi 6.1 sqarojmë se sektori i taksave ka marrë masat duke kompletuar të gjitha dosjet e biznesit me dokumentacionin e nevojshëm dhe inventarizuar dosjet, si dhe ngarkesat fiskale përkatëse.*

-Te rekomandimi 2.1 nuk i përket sektorit të taksave për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore por sektori të kontrollit në terren dhe borxhit tatimor i cili merret me mbledhjen e Borxhit Tatimor.
-Te rekomandimi 4.1 është përgjegjësi e sektorit të shërbimeve publike dhe jo sektori i taksave dhe tarifave vendore etj.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë pikë nuk merret në konsideratë, pasi grupi i auditimit i drejtohet Bashkisë Vau i Dejës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupet e mërshme por edhe nga rekomandimet që lihen gjatë auditimit për problematikat e konstatuara, me qëllim për të përmirësuar punën në vijim.*

IV. REKOMANDIME:

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) në Bashkinë Vau i Dejës rezultoi se nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm. Konkretisht, strukturat organizative nuk kanë hartuar plane vjetore pune, nuk kanë dokumentuar gjurmët e auditimit për proceset kryesore të veprimtarisë, si dhe nuk kanë përgatitur regjistrat e riskut në nivel drejtorie, sektori dhe institucioni. Gjithashtu, në procedurat e rekrutimit të punonjësve, marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës, u konstatua mungesa e kritereve të miratuara dhe të dokumentuara për përzgjedhjen e kandidatëve, duke mos garantuar transparencë, objektivitet dhe gjurmueshmëri të procesit. Veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, nenin 4, pika 20; nenin 8, pika 8, shkronja "b"; nenin 15, pikat 1–4; nenin 16, pikat 2–3; nenin 17, pika 1; nenin 21, pika 2; dhe nenin 27, pikat 1–2; me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2 dhe pika 2.2.4, nënpikat 1–5; si dhe me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pikat 2.2.6 dhe 2.5.2, si dhe Kapitulli III, pikat 3.1 dhe 3.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa për forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke:

- hartuar dhe miratuar regjistrin e riskut në nivel institucioni dhe për çdo drejtori/sektor, me identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin periodik të risqeve;
- hartuar dhe përditësuar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset dhe aktivitetet kryesore të institucionit, në funksion të rritjes së gjurmueshmërisë dhe përgjegjshmërisë administrative;
- hartuar plane vjetore pune për çdo strukturë organizative, të lidhura me objektivat institucionale;
- përcaktuar dhe dokumentuar kriteret e përzgjedhjes për punonjësit që punësohen sipas Kodit të Punës, në mënyrë që procedurat e rekrutimit të jenë transparente, të dokumentuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i organizimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në Bashkinë Vau i Dejës rezultoi se:
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenet 12, 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar;

-Nuk janë audituar aktivitete që kryen Bashkia Vau i Dejës, të cilat vlerësohen me risk të lartë, si Sektori i Inspektoriati të Mbrojtjes së Territorit Vendor, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit;
-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
-NjAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;
-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12;
- NjAB në Bashkinë Vau i Dejës nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI, pika 6.3 *"Dosja e Përhershme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 21-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë së Vaut të Dejës në bashkëpunim me Njësinë e Auditit të Brendshëm, të marrin masa si vijon:
- Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.
- Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, si një organ i pavarur.
- Në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhim auditimi, audituesit të respektojnë strukturën e përcaktuar dhe të plotësojnë opinionin e përgjithshëm lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Vau i Dejës për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 226,389,688 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën:
- prej 217,088,953 lekë për taksat dhe tarifat ndaj kategorisë familjar;
- prej 9,300,735 lekë detyrime të tjera.

Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë" (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "ë", pika 3, neni 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja "c" dhe pika 10 në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë nr. 470 "Të ardhura për t'u marrë".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 40,587,301 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe nga autoriteti kontraktor nuk ka pasur kërkesa drejtuar operatorëve ekonomik lidhur me cilësinë e punimeve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 (klasa 4) në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kadastrës dhe Investimeve Bashkia Vau i Dejës të marrin masat e nevojshme, me qëllim likuidimin e vlerës së garancisë së punëve publike, të cilat janë të kontabilizuara si active dhe i ka kaluar afati i garancisë së kontratës. Në vijim Drejtoria Ekonomike të kryejë kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 14,909,740 lekë. Nga verifikimi i kryer në databazën e QKB-së, ka rezultuar se Bashkia Vau i Dejës zotëron aksione në disa Shoqëri Aksionare. Konkretisht Bashkia Vau i Dejës, zotëron aksione në Shoqërinë Rajonale U. K. Shkodër, NIPT M3…….O, me pjesëmarrje 3.230 %, 12,493.64 aksione me vlerë nominale të aksionit 1.000 lekë, pra 12,493,640 lekë; Shoqërinë Aksionare Z. A, NIPT M2…….I, me pjesëmarrje 100 %, 1 kuotë me vlerë 100 lekë, pra 100 lekë, si dhe Shoqërinë Aksionare Ndërkomunale Bushat, NIPT K87108002A, me pjesëmarrje 100 %, 24,160 aksione me vlerë nominale të aksionit 100,000 lekë, pra 2,416,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet në seksionin 3.1, paragrafi 31 UMF nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, si dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr.26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 203 "Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme" rezulton se në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerën 0 lekë e pa ndryshuar edhe në fund të vitit 2025. Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion (ditarit të bankës) rezultoi se Bashkia Vau i Dejës, Sektori i Taksave dhe Sektori i Financës, kanë në përdorim dy programe kompjuterike për aktivitetin e tyre, konkretisht programin "Alpha Cloud" për kontabilitetin dhe programin "SiZ1N" për taksat dhe tarifat vendore. Sa më sipër konstatohet se llogaria nr.203 "Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme" është nënvlerësuar me 2,109,847 lekë, kosto e blerjes së dy programeve kompjuterike. Këto veprime janë në kundërshtim me Funksionimin kontabël i llogarive të klasës 2, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës 2,109,847 lekë në llogarinë nr. 203 "Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr. 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" u konstatua se në këtë llogari, nuk është kontabilizuar vlera 1,451,880 lekë, nga të cilat 384,000 lekë janë punime riparimi në objekte të ndryshme dhe 1,067,880 lekë është blerja e katër kioskave turistike, kryer përgjatë vitit 2025. Vlera e mësipërme nuk është kapitalizuar në aktivet përkatëse. Shpenzimet e mësipërme janë klasifikuar si shpenzime operative dhe jo si shpenzime për investime. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "b", pikën 2, Klasën 2 "Aktivet afatgjata" në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për evidentimin dhe kontabilizimin e vlerës prej 1,451,880 lekë në llogarinë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale, duke bërë kapitalizimin e vlerës prej 1,067,880 lekë për blerjen e katër kioskave turistike dhe trajtimin kontabël të përshtatshëm të vlerës prej 384,000 lekë për punimet e riparimit. Gjithashtu, të merren masa që në vijim çdo investim, blerje ose ndërhyrje që plotëson kriteret për njohje si aktiv afatgjatë material të identifikohet, dokumentohet dhe regjistrohet në kohë në llogaritë përkatëse kontabël.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr. 210 "Toka, Troje, Terrene" nr. 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" të pasqyrave financiare, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:
-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;
-Vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës dhe ish Komunave, aktualisht Njësi Administrative. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 26, 27, 30 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës, të marrë masat e nevojshme, për:
- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 "Toka, Troje, Terrene", nr.211 "Pyje, kullota, plantacione" dhe nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione".
- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit (për llogarinë nr.212 "Ndërtesa dhe konstruksione"), kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr.42; 431, 435 dhe 436, rezultoi se në fund të vitit 2025 janë në vlerën prej 33,648,595 lekë. Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve të muajit Janar të vitit 2026 lidhur me likuidimin e detyrimeve të mësipërme, janë konstatuar diferenca në kontabilizim, si dhe mungesë të kontabilizimit, në vlerën 1,524,942 lekë, kryesisht vlera e pagave dhe ndalesave mbi pagë nuk përputhen me vlerën e kontabilizuar, si dhe nuk janë kontabilizuar shpërblime për këshilltarët e Bashkisë Vau i Dejës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, shkronja "ë", pika 3, neni 12; Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së

përgjithshme", i ndryshuar, rubrika 3.3 "Detyrimet Afatgjata". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për rakordimin dhe saktësimin e regjistrimeve kontabël për llogaritë nr. 42, 431, 435 dhe 436, duke evidentuar dhe regjistruar të gjitha detyrimet reale sipas dokumentacionit justifikues.

9.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të kryej veprimet korrigjuese në kontabilitet për diferencat e konstatuara në vlerën 1,524,942 lekë, përfshirë regjistrimin e shpërblimeve për këshilltarët e bashkisë dhe korrigjimin e mospërputhjeve ndërmjet listëpagesave, ndalesave mbi pagë dhe vlerave të kontabilizuara.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2025, ka rezultuar se nuk është nxjerrë urdhri Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës për kryerjen e procesit e inventarizimit të aktiveve, si rrjedhojë llogarite analitikë janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 2, neni 4, pika 9; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5 pika 36, pika 52, pika 73, pika 85. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të marrë masat e nevojshme për ngritjen e komisionit për kryerjen e procesit të inventarizimit fizik të Aktiveve Afatgjata dhe Afatshkurtra Materiale.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave të performancës financiare rezultoi se llogaria nr.681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit" në fund të vitit 2024 është në vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2025 është në vlerën 293,249,565 lekë. Sa më sipër u konstatua se është njohur si shpenzim në pasqyrën e performancës financiare, vlera e amortizimit 293,249,565 lekë të përllogaritur për aktivet e trupëzuara dhe jo të trupëzuara të Bashkisë Vau i Dejës, ndërkohë kjo llogari përdoret për amortizimin e AAGJ-së (në analizat përkatëse), si element kostoje, në institucionet, që krahas aktivitetit buxhetor realizojnë edhe aktivitet tregtar apo prodhimi, si dhe në amortizimin e subvencioneve për investime. Vlera e amortizimit të mësipërm debitohet në llogarinë nr.1013 "Pakësim fondi nga amortizimi i AAGJ" me kundërparti kreditimin në llogarinë nr.219 "Amortizimi i aktiveve afatgjata". Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 4 në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 47-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar Bashkia Vau i Dejës të marrë masat e nevojshme, për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr.681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit", si dhe kryerjen e veprimeve kontabël në debi të llogarisë nr.1013 "Pakësim fondi nga amortizimi i AAGJ" me kundërparti kreditimin në llogarinë nr.219 "Amortizimi i aktiveve afatgjata".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2025, rezulton se është realizuar në masën 53%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 2,156,854,033 lekë është realizuar vlera 1,135,388,670 lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një viti më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

"Menaxhimi i Mbetjeve" është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 78,894,303 lekë është realizuar në masën 24,835,806 lekë ose 31%. Kjo tregon se planifikimi dhe ndjekja e zbatimit të programit nuk kanë siguruar një realizim në përputhje me objektivat e miratuara, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936/2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, për planifikim realist dhe përdorim efektiv të fondeve publike.

Detyrimet e prapambetura të raportuara në fund të vitit 2025, konstatohet se janë në vlerën 4,919,131 lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit prej 693,373,988 lekë, zë 0.71 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 60 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Vau i Dejës, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2025, ky afat nuk është respektuar në 29 raste për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 20,605,376 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të Ligjit nr.68/2017, i ndryshuar, pikën 24 dhe 25 të nenit 3, nenin 47 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe pika 184 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar të marrin masa për përmirësimin e planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit, duke u bazuar në nevojat reale dhe në burimet e disponueshme të financimit, si dhe të hartojnë e zbatojnë grafikun për likuidimin në kohë të detyrimeve të prapambetura, duke analizuar periodikisht devijimet nga plani, me qëllim rritjen e realizimit të programit dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2025-2027, u konstatua se:

- Nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"*, i ndryshuar, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS-ja);
- Nuk janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në shkronjat "a-h" të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Vau i Dejës, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (si dhe mungon një analizë e detajuar); Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore", pika 19 dhe pikat 22-23; pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017, i ndryshuar; pika 29, shkronjat "a-h" të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor të sigurohet:

-Dokumentimi i procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;
-Pasqyrimi dhe trajtimi i risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;
-Planifikimi i fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës.
-Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për publikimin e informacioneve mbi monitorimin e buxhetit në faqen zyrtare të Bashkisë Vau i Dejës.

Gjatë planifikimit të PBA buxhetit vjetor pasardhës

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën e KLSH nr. 36/13, datë 14.10.2025, rezultoi se: Bashkia Vau i Dejës ka dërguar planin e masave brenda afatit 20-ditor, por nuk ka paraqitur raportimin 6-mujor mbi ecurinë e zbatimit.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të Ligjit nr.154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
-Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, kemi si vijon:
Nga 23 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 23 masa, është zbatuar 1 masë dhe nuk janë zbatuar 22 masa organizative.
- 1 masë e ardhur e munguar në vlerën 352,589,965 lekë, e pranuar nga subjekti por nuk është zbatuar.
- 1 masë për eleminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, në vlerën 226,389,688 lekë, pranuar nga subjekti por nuk është e zbatuar.
- 3 masa disiplinore janë pranuar nga subjekti por nuk janë zbatuar.
Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 58-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Masa Organizative të lëna në auditimin e fundit të kryer nga KLSH përcjellë me shkresën nr. 36/13, datë 14.10.2025.
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës dhe Këshilli Bashkiak, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit të përgjithshëm strategjik të zhvillimit. Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, regjistrin e riskut, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin e risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit si dhe gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.
2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që pranimi i punonjësve të realizohet përmes një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë, bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit, me qëllim rekrutimin efektiv të burimeve njerëzore. Gjithashtu të marrë masa për plotësimin, sistemimin dhe administrimin me të dhënat e nevojshme dosjet e personelit për çdo të punësuar si dhe hatimin e një programi trajnimesh për punonjësit.
4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë kontabilizimin e llogarisë 604 *"Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë"* të llogarisë 606 *"Transferta për buxhet familjarë e individët"* dhe llogarisë 231 *"Investime në proces",* për të siguruar përputhjen midis vlerave të rakorduara me thesarin dhe vlerave të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar dhe te performancës financiare. Gjithashtu të sigurojë që kontabilizimi në llogaritë e aktiveve AAGJM-ve të kryhet në

momentin e kapitalizimit të investimeve dhe jo në vlera pjesore të cilat i përkasin llogarisë 230 - 231 *"Investime në proces"*.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* për vlerën 126,103,912 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 63 *"Ndryshimi gjendjes së inventarit"* për vlerën 156,101 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar gjendjen e llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* për vlerën prej 112,682,760 lekë.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar gjendjen e llogaris 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë"* për detyrimet që rezultojnë të shtuara për vitin 2024 në vlerën prej 68,629,996 lekë dhe llogarinë 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"* për detyrimet e viteve të mëparshme për vlerën 57,570,281 lekë.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar amortizimin për llogarinë 202 *"Studime e projektime",* llogarinë 212 *"Ndërtime e konstruksione",* llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"*, llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri e pajisje",* llogarinë 215 *"Mjete Transporti"* dhe llogarinë 218 *''Inventar ekonomik''*.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Aseteve ne bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit te marrin masa për regjistrimin e aseteve te Bashkisë dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për vlerën prej 74,319,968 lekë midis të dhënave të thesarit dhe të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar për llogarinë 23 *"Investimet".*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë së Vaut të Dejës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve të bashkisë konform legjislacionit në fuqi.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të identifikojë objektet që i përkasin ujësjellësve dhe të kryejë procedurat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh. A" me NIPT M37819701O.

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të hartojë pasqyrat financiare të konsoliduara, duke përfshirë kompanitë të cilat kontrollohen në kapitalin e tyre nga njësia Bashkia Vau i Dejës.

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 4864 *"Detyrimet e prapambetura"* për mospërputhjen e saj në vlerën 5,443,875 lekë.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 475 "Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse" për vlerën 121,303,924 lekë dhe të sigurojë paraqitjen e saj të saktë në llogarinë 470 "Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë".

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" e cila është nënvlerësuar për vlerën 234,356,333 lekë në fund të vitit 2024.

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë "Shpenzime te tjera", e cila është e paraqitur në mënyrë të pasaktë për vlerën prej 145,093,403 lekë.

22.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në process, të cilat janë përcjellë me shkresat nr.1091/20 prot., datë 26.03.2025; nr.1027/5 prot., datë 06.03.2024; nr.1021/8 prot., datë 27.03.2023 si më poshtë vijon:

[15]Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për caktimin e supervizorit të pastrimit, për mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe njësive administrative, mbajtjen të të gjithë dokumentacionit të mbikëqyrjes së kërkuar si dhe mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa pastrimit, që mblidhet për këtë qëllim.

Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për reduktimin e shpenzimeve të karburantit dhe mbajtjen e një dokumentacioni të argumentuar për harxhimin e tij, duke, plotësuar fletudhëtimet me gjithë të dhënat që kërkohen; plotësuar akt-rakordimet, sipas kilometrave të përshkuara; vlerësimin e gjendjes teknike të disa automjeteve nëse janë rentabël ose jo dhe vendosjes së një raporti të drejtë midis numrit 23 të automjeteve me nevojën, ngarkesën dhe shfrytëzimin e tyre.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për realizimin e një planifikimi të studiuar dhe të argumentuar me dokumente dhe të dhëna të sakta për taksat dhe tarifat vendore, raportimin veçmas të vlerës të paguar për vitin ushtrimor dhe veçmas për vlerën e detyrimeve prapambetura te paguara taksave vendore, nëpërmjet përfshirjes në një kolonë të veçantë në sistemin elektronik të detyrimeve të prapambetura të taksave vendore.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve të tokës tepër nga legalizimi ose AMTP kaluar "shtet", për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim si dhe për sipërfaqet e tokës tepër kaluar shtet, si rezultat i diferencave midis AMTP dhe librit të ngastrës sipas sipërfaqes faktike në terren, duke bashkëpunuar me ASHK Shkodër.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për kompletimin e dosjeve të bizneseve me dokumentacionin e kërkuar, të rishikoje ngarkesat fiskale, të llogarisë taksën e ndërtesës për 1 rast të shmangur si dhe të inventarizojë dosjet e subjekteve.

10.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për regjistrimin e plotë dhe të saktë në sistemin e kontabilitetit të të gjitha aseteve të transferuara me akte ligjore dhe nënligjore duke përfshirë sipërfaqen e transferuar me çmimin përkatës të referencës. Të kryhet procesi i regjistrimit analitik në kartela të veçanta i të gjithë aseteve të cilat paraqiten pa informacion historik në regjistrin e aseteve duke shfrytëzuar të dhënat e thesarit ndër vite dhe në të njëjtën kohë të llogaritet amortizimi për këto asete.

16.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për shlyerjen e detyrimeve për mallra e shërbime brenda vitit buxhetor në të cilin paraqitet fatura e furnitorit për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara. Të kryhen veprimet rregulluese për rastet e parapagimeve dhe të njihet shpenzimi pasi të jetë vërtetuar sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Për rastet e transfertave drejt njësive të tjera në llogarinë 604 dhe 603 dokumentacioni shoqërues i praktikës të shoqërohet me vendimmarrje për llojin e transfertës në formën e grantit, borxhit apo rritjes së kapitalit në mënyrë që të gjykohet për klasifikimin e drejtë të artikullit kontabël dhe konsistent për transaksione të ngjashme.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të pajisin me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit në ASHK – Shkodër.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kullosor dhe të ndjekë procedurat ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.

[15] -Masat të dërguara me shkresën e KLSH-së me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025, zbatimi i të cilave është audituar në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës në të gjitha rastet e dhënies me qira të aseteve të ndjekë procedurat ligjore, të pajisë me certifikatë pronësie asetet dhe të përcaktojë saktë llojin e asetit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
22.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndërmarrë masat për subjektin A. T, ShPK. dhe A –B 07 të zbatojë procedurat sipas ligjit për ndështkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor.
23.1. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vau i Dejës, rast pas rasti të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eleminimin e praktikave të tilla, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike të çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.
24.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa që në hartimin e regjistrave të parashikimit të prokurimit publik sipas kërkesave të njësive respektive të prokurohen me procedura të hapura nevojat për mallra dhe shërbime të ngjashme/njëjta me qëllim shmangien e procedurës së blerjeve të vogla.
25.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të dokumentohet përllogaritja e fondit limit dhe të gjitha dokumentacionet e tjera që provojnë normativat dhe kilometrat/orët e punës për përllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit që përfshijnë blerje karburanti si dhe KVO të përfshijë specialistë të fushës.

- Masa organizative përcjellë me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024.
Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kërkesat e "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
1.2. Rekomandimi: Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim te Titullari nga secila drejtori/sektor, etj., si dhe të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.
14.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 21 pronave të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës.
15.1. Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara", të lëna në audtimet e mëparshme.
1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vau Dejës të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të planifikojë të ardhura nga taksa e ndikimit në

infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 2,847,329 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e lartpërmendura të Bashkisë Vau Dejës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën dhe me pas sipas procedurave të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Vau Dejës me vlerë 3,116,667 lekë për vitin 2022 dhe vlera 15,800,000 lekë për autorizimet vlera progresive. Gjithashtu, Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqërinë "S.P.E. Gjadër ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e shërbimit Pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

- Masat të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023.

Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

- Për masat e rubrikës "Për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (të ardhura të munguara)":

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 19,300,000 lekë sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimet e mëparshme.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,705,953 lekë pa TVSh nga OE "A. I. G. C" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4747/8 prot., datë 16.11.2022, me objekt "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera. Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e defekteve në objektin e prokurimit "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi (2022)", me qëllim riparimin e tyre, para përfundimit të periudhës së garancisë.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,431,375 lekë pa TVSh nga OE "K" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4931/8 prot datë 30.11.2022, me objekt "Ndërtim pike grumbullimi për produktet bujqësore", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 305,922 lekë pa TVSh nga OE "V. E" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4806/9 prot., datë 24.11.2022, me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,752,040.7 lekë pa TVSh nga BOE "L. C" ShPK & "A. I. G. C" d.sh.h & "2T" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.4885/10 prot., datë 18.10.2023, me objekt "Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e lidhjes së kontratës jo me vlerën reale të ofertuar.
5.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të përcaktohen përgjegjësitë dhe të merren masa për të arkëtuar shumën prej 404,578 lekë për rastin e tërheqjes nga oferta të operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi.
6.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,528,196 lekë për TVSh të përfituar tepër, në 2 raste për "pajisjet elektrike, ndriçimit rrugor", konkretisht:
- vlerën 678,156 lekë nga subjekti "G. H, PF";
- vlerën 850,040 lekë nga subjekti "L. C" ShPK.

Masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficience dhe efektivitet të fondeve publike, të lëna në auditimet e mëparshme.
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përllogaritjes së fondit limit në total në shumën 993,670 lekë në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës.
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të sipërcituara dhe të marrë masa për eleminimin e praktikave të tilla, të cilat kanë shkaktuar përdorimin pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 13,052,857 lekë.
3.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për prokurimin e nevojave brenda buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe në përputhje me kohëzgjatjen e planifikuar të kryerjes së investimeve në rastin e punëve publike.

Masa disiplinore, të lëna në auditimet e mëparshme.
Mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", dhe në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë", neni 37, "Masa disiplinore", i ndryshuar, si dhe në kontratën e punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse:

E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil,
a. "Vërejtje" deri në "Largim nga shërbimi civil", sipas shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit, për punonjësit si më poshtë:
1. Z. E. S, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
2. Z. E. M, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
3. Znj. D. D, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
4. Znj. M. M, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
5. Znj. M. M, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
6. Znj. R. Gj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
7. Znj. S. V, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
8. Z. M. Gj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
9. Z. A. M, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

10. Zj. D. L, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimi dhe personit përgjegjës për prokurimet.
11.Znj. K. Sh, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimit;
12.Znj. E. Z, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe specialiste e fushës në dy raste;
13. Znj. K. C, anëtar i NJP dhe specialist i fushës në një rast;
14. Z. A. F, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
15. Znj. E. T, në rolin e nëpunësit zbatues për periudhën objekt auditimi,
16. Z. N. B, me detyrë Përgjegjës i Sektorit te Aseteve,
17. Znj. A. Sh, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit,
18. Z. M. L, me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së,
19. Z. V. Sh, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit,
20. Z. E. P, me detyrë Përgjegjës i sektorit te inspektimit te Pyjeve dhe Kullotave,
21. Znj. Gj. N, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore,
22. Z. G. Rr, me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore,
23. Znj. R. L, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore,
24. Znj. L. N, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore,
25. Znj. S. Gj, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore.
26. Z. A. G, me detyrë specialist i bujqësisë,
27. Znj. A. V, me detyrë specialiste e bujqësisë,
28. Znj. M. Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore,
29. Z. Z. P, me detyrë Përgjegjës i sektorit të bujqësisë i bashkisë,
30. Z. S. L, me detyrë Përgjegjësi i shërbimeve të administratës së bashkisë.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2025 është në vlerën **254,991,805 lekë** lekë, nga të cilat vlera e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2025 është 43,130,498 lekë dhe pakësimet gjatë vitit 2025 janë në vlerën 74,522,151 lekë.

Sa më sipër, në krahasim me vitin 2024, vlera debitore është ulur me 31,391,653 lekë. Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Vau i Dejës në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta. Për debitorët e mësipërm nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori i Kontrollit dhe Borxhit Tatimor Bashkia Vau i Dejës, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, janë mjaftuar me masat shtrënguese si, dërgimin e njoftimit të detyrimeve si dhe urdhërat për bllokimin e llogarive bankare të nivelit të dytë për subjektet debitore, por nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese sipas kërkesave të nenit 114, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat tatimore në R.SH"* i ndryshuar me Ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar" nenet 88-104. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Kontrollit dhe Borxhit Tatimor në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **254,991,805 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për kontratat e qiradhënies së aseteve, lidhur ndërmjet Bashkisë Vau i Dejës me palë të treta konstatohet që:
Bashkia Vau i Dejës në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, për vitin 2025 ka gjithsej 100 kontrata qiraje aktive, kryesisht për dhënie me qira fond pyjor, dhënie me qira truall dhe dhënie me qira ndërtese në njësinë qendër dhe njësitë administrative, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2008-2025 me afat qiraje nga 1 deri 99 vjet. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore u konstatua se në fund të vitit 2024 është në vlerën 42,070,937 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2025 është në vlerën 11,228,715 lekë, gjendja e debitorëve nga kontratat e qirave në mënyrë progresive në fund të vitit 2025 janë në vlerën 53,299,652 lekë për 36 kontrata të cilat janë të kontabilizuara dhe janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës. Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit "zgjidhja e kontratës" në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbarimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit. Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet pagesa, po në zbatim të kapitullit "zgjidhja e kontratës", nga Bashkia zgjidhet kontrata për mospërmbushje të kushteve të saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore **53,299,652 lekë**, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës nga 36 qiramarrësit e tokës bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT Bashkia Vau i Dejës, u konstatua se deri më datë 31.12.2025 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 31 subjekte të gjobitura në vlerën **70,697,478 lekë, vlerë e cila është e kontabilizuar**. Për vitin 2025 vlera e borxhit të krijuar nga gjobat e vendosura nga IMT janë në vlerën 46,690,008 lekë. Gjithashtu në zbatim të VKM-së nr. 274 datë 09.05.2024, janë falur 20 gjoba në vlerën 21,833,481 lekë.
Nga auditimi u konstatua se gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit është nxjerrë Urdhri i Ekzekutimit për të gjitha gjobat e vendosura.
Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit nuk është marrë asnjë masë për mbledhjen dhe arkëtimin e detyrueshëm të gjobave të vendosura, si dhe nuk janë aplikuar kamatvonesa për subjektet e gjobitura. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 30, 31, 32 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", nenet 164, 165, 170, 172 dhe 173 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative në RSH", neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMT-së të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMT për arkëtimin e vlerës **70,697,478 lekë**.
-IMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2025 në mënyrë progresive janë vendosur 83 gjoba në vlerën 244,800 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës, të cilat janë të pakontabilizuara. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 "*Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës*", i ndryshuar, si dhe pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim me sektorin e Policisë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 244,800 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore, pasqyryar në kapitullin anekse tabela nr.38 bashkëngjitur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Tatim-Taksave të Bashkisë Vau i Dejës, lidhur me administrimin, evidentimin dhe arkëtimin e taksës së fjetjes në hotel nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin "Hoteleri", rezultoi se për vitin 2025 të ardhurat nga kjo taksë janë realizuar në vlerën 391 mijë lekë, kundrejt planifikimit vjetor 103 mijë lekë, duke arritur nivelin 380% të planit.

Nga verifikimi i procedurave të ndjekura për administrimin e kësaj takse u konstatua se llogaritja dhe aplikimi i saj mbështetet kryesisht në deklarimet e vetë subjekteve, ndërkohë që nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë nuk janë kryer kontrolle të mjaftueshme në terren për verifikimin e saktësisë së deklarimeve.

Në veçanti, nuk rezulton të jetë administruar dhe përditësuar në mënyrë të plotë informacioni mbi kapacitetin akomodues të subjekteve, përfshirë: numrin e dhomave të disponueshme për aktivitet, numrin e shtretërve për dhomë dhe në total, numrin e dhomave aktive gjatë periudhës së aktivitetit, si dhe numrin e personave/netëqëndrimeve të realizuara. Mungesa e këtyre të dhënave dhe e kontrolleve periodike krijon risk për nëndeklarimin e numrit të personave të akomoduar dhe, për rrjedhojë, për llogaritjen dhe arkëtimin jo të plotë të taksës, veçanërisht gjatë periudhave me fluks të shtuar turistik.

Gjithashtu, nga auditimi i procedurave për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve të prapambetura rezultoi se, deri më 31.12.2025, detyrimi debitor për taksën e fjetjes në hotel arrin në 128,100 lekë, për 2 subjekte. Gjatë vitit 2025 janë kryer likuidime në vlerën 399,395 lekë, ndërsa për detyrimet e mbetura nuk rezulton të jenë ndërmarrë në mënyrë të plotë dhe në kohë masat administrative/shtrënguese të parashikuara për vjeljen e tyre.

Sa më sipër, mangësitë në kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të subjekteve, si dhe mosndjekja në kohë e detyrimeve të papaguara, kanë ndikuar në dobësimin e procesit të administrimit të kësaj të ardhure dhe kanë krijuar risk për mosrealizimin e plotë të të ardhurave që i takojnë buxhetit të Bashkisë Vau i Dejës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun I.7, tabela nr.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2025. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, nëpërmjet Sektorit të Tatim-Taksave dhe strukturave përgjegjëse për kontrollin në terren, të marrë masa për:

Evidentimin dhe përditësimin e regjistrit të subjekteve të hotelerisë, duke përfshirë për çdo subjekt numrin e dhomave, kapacitetin në shtretër, numrin e dhomave aktive dhe periudhën e ushtrimit të aktivitetit.

Vendosjen e një procedure të dokumentuar kontrolli dhe rakordimi periodik ndërmjet deklarimeve të subjekteve dhe të dhënave të verifikuara në terren, veçanërisht gjatë sezonit turistik, me qëllim garantimin e llogaritjes së saktë të taksës së fjetjes.
Kryerjen e kontrolleve të bazuara në risk për subjektet e hotelerisë, duke i kushtuar përparësi subjekteve me kapacitet të lartë akomodues, deklarime të ulëta në raport me kapacitetin dhe/ose diferenca të përsëritura në deklarime.
Të merren masat administrative dhe shtrënguese të parashikuara nga kuadri ligjor dhe Paketa Fiskale e Bashkisë Vau i Dejës për subjektet debitore, me qëllim vjeljen e detyrimeve të papaguara, duke dokumentuar në çdo rast veprimet e ndërmarra për vlerën prej **128,100 lekë**.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në VKM-në nr.115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës**, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. "Vërejtje" në zbatim të germës "a" të nenit 58, për 3 punonjës;

1. Znj. E. T, Drejtore e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, 2.2, dhe 2.3 faqe 12-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2. Z. M. Gj, me detyrë Përgjegjës i Tatim Taksave, për mangësitë e konstatuara në mosplanifikimin e saktë të planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3. Z. Gj. D, me detyrë Agjent i Mbledhjes së Borxhit, për mangësitë e konstatuara për zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 *"Për Nëpunësin Civil"*, të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 *"Për Nëpunësin Civil"*, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT